



100-vjetori i vendosjes së marrëdhënieve mes Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë

Ambasadorja Yuri Kim është shprehur krenare për Shqipërinë në eventin e organizuar për kremtimin e 100-vjetorit të vendosjes së marrëdhënieve me Shtetet e Bashkuara. Gjatë fjalës së saj, Kim theksoi se SHBA nuk është lëkundur asnjëherë në besimin e saj tek Shqipëria. "Ishte një pishtar që nuk u lejua kurrë të shuhej. Ndërsa shënojmë një shekull marrëdhënie, duhet të vlerësojmë veçanërisht ata shqiptarë që paguan duke dhënë jetën e tyre. E pandryshuar mbetet, SHBA-të kurrë nuk janë lëkundur nga besimi në një Shqipëri të pavarur dhe sovranë. Ne kurrë nuk jemi lëkundur në besimin që kemi në miqësinë tonë. Ne ishim krenarë kur ju mbështetëm kur ju u shkëputet nga zinxhirët e regjimit. Krenar që u anëtarësuat në NATO. Sërish krenar që të festojmë me ju që ju filluat zyrtarisht negociatat me BE-në. SHBA-të nuk janë lëkundur kurrë, për sovranitet", - deklaroi ambasadorja Kim.



Ish-presidenti amerikan George W. Bush nëpërmjet Ambasadores Yuri Kim ka përcjellë mesazhin e tij për vendosjen e 100-vjetorit të marrëdhënieve të Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë. "Unë dhe Laura ju dërgojmë përsëritet më të ngrohta. Ky gur kilometrik është dëshmi e miqësisë. Në vitin 2007 isha krenar që isha presidenti që vizitova Shqipërinë. U bëra dëshmitari mikpritjes tuaj të singertë. Jam i lumtur të shoh Shqipërinë dhe SHBA-të si aleatë. Shpirti shqiptar që kurrë nuk rresht për liri dhe tradita juaj e besës janë vlera. Gëzuar të gjithëve 100-vjetorin", - ka shkruar në letrën e tij ish-presidenti amerikan.

Bajram Begaj betohet në Kuvend si President i Republikës

Presidenti Begaj: Do të jem shërbëtor i popullit tim, përfaqësues i unitetit tonë kombëtar, mbështetës i palëkundur i rrugëtimit euroatlantik



» faqe 3

Ministri Peleshi: Në emër të popullit shqiptar, familjarëve tuaj, iu dërgoj një falënderim dhe iu përulëm për edukimin e tyre, të këtij brezi ushtarakësh kaq të rëndësishëm për Shqipërinë

Në ambientet e garnizonit ushtarak "Skendërbej" u organizua ceremonia e diplomimit të KPO 2022. Të pranishëm në ceremoni ishin ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, zëvendësministria e Mbrojtjes Dallëndyshe Bici, drejtori i Shtabit të Përgjithshëm Bilbil Bitri, atashe ushtarakë të akredituar në vendin tonë, gjeneralë, komandantë, drejtues të FA-së, si dhe familjarë të studentëve, të cilët kishin...



» faqe 4

Zëvendëshefi i SHPFA pret në takim atasheun ushtarak të Kanadasë

Zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Manushaqe Shehu priti në një takim kortezie atasheun ushtarak të Kanadasë rezident në Itali, kapiten i rangut I André Boisjoli. Gjeneralmajor Shehu në fjalën e saj vlerësoi bashkëpunimin ushtarak midis dy vendeve, duke veçuar rolin e Kanadasë në trajnimin dhe arsimimin e personelit ushtarak shqiptar ndër vite. "Vlerësoj kontributin e vyer të një vendi partner si Kanadaja, në përgatitjen e personelit ushtarak shqiptar dhe sot ne jemi krenar që shërbejmë krah për krah në operacione të...



» faqe 2

KOLONEL HALIL KATANA, ushtaraku, gazetari dhe qytetari me gjurmë të arta në panteonin e vlerave të FA-së

Halil Katana ka lindur më 15 dhjetor 1939, në fshatin Degë të Tropojës, në një familje me tradita të shquara atdhetare, me emër në Malësinë e Gjakovës. Stërgjyshi i Halilit, në vitin 1852, kish rënë në luftë për mbrojtjen e trojeve amtare nga ushtria pushtuese malazeze. Gjyshi, Avdyli, kish marrë pjesë në Kuvendin e Junikut dhe ishte bashkuar me forcat kryengritëse të vitit 1910, të komanduara...



» faqe 11

Takimet

Ministri i Mbrojtjes takohet me përfaqësues të kompanive "Lockheed Martin" dhe "Airbus Helicopters"

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi u takua gjatë vizitës zyrtare në Britaninë e Madhe me zëvendës presidentin e kompanisë amerikane "Lockheed Martin" për Europën, z. Jonathan Hoyle. Mes palëve u diskutua rreth projekteve aktuale dhe atyre në vijim që FA ka me firmën prestigjioze të teknologjisë së mbrojtjes "Lockheed Martin", në veçanti për operacionalitetin e Sistemit të Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Ajrore të Republikës së Shqipërisë, si dhe mirëmbajtjen e Sistemit të Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Detare të vendit.

Gjatë bisedimeve, ministri Peleshi u shpreh se të dy palët duhet të eksplorojnë të gjitha avantazhet, disavantazhet dhe përfitimet nga ky bashkëpunim, duke shprehur besim në performancën dhe gjurmët e "Lockheed Martin" deri në zbatimin e plotë të projekteve që kjo firmë ndërmerr.

Një takim të veçantë ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi dhe delegacioni që e shoqëronte zhvilloi edhe me zëvendës presidentin e kompanisë



"Airbus Helicopters" për Europën Juglindore dhe Izraelin, z. Cesar Sanchez Lopes. Bisedimet u fokusuan në problematikat aktuale dhe

gjetjen e mekanizmave dhe hapësirave të reja për përmirësimin e procesit të mirëmbajtjes së helikopterëve të Forcave të Armatosura të Shqipërisë.



Zëvendësshefi i SHPFA pret në takim atasheun ushtarak të sapo akredituar të Republikës së Kosovës, nënkolonel Enver Hotin

Zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Manushaqe Shehu priti në një takim kortezie atasheun ushtarak të Republikës së Kosovës, nënkolonel Enver Hotin, në kuadër të marrjes së detyrës në Tiranë.

Gjeneralmajor Shehu në fjalën e saj, vlerësoi bashkëpunimin ushtarak të shkëlqyer midis dy vendeve, veçanërisht në fushat e trajnimit, arsimimit dhe stërvitjeve, duke veçuar planet e bashkëpunimit dhe stërvitjet "Defender", ku të dyja vendet luajnë një rol të veçantë promovues për paqen, sigurinë dhe stabilitetin e rajonit.

"Transformimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës sipas standardeve perëndimore është një histori suksesi dhe ne ndihemi krenarë që sot FSK stërvitet përkrah Aleancës së NATO duke kontribuar jo vetëm për sigurinë e rajonit, por edhe më gjerë", - u shpreh ndër të tjera gjeneralmajor Shehu. Nga ana e tij, nënkolonel Hoti e siguroi zëvendësshe-



fin e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së se është i përkushtuar për rritjen e bashkëpunimit dhe forcimin e marrëdhënieve bilaterale, duke punuar me të njëjtin intensitet si paraardhësi i tij në detyrë, kolonel Shillova. Në

përfundim, gjeneralmajor Shehu duke i uruar suksese në detyrë, e garantoi nënkolonel Hotin mbi mbështetjen e pakursyer të FARSH në thellimin e bashkëpunimit në fushën e Mbrojtjes midis dy vendeve.

Zëvendësshefi i SHPFA pret në takim atasheun ushtarak të Kanadasë

Zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Manushaqe Shehu priti në një takim kortezie atasheun ushtarak të Kanadasë rezident në Itali, kapiten i rangut I André Boisjoli. Gjeneralmajor Shehu në fjalën e saj vlerësoi bashkëpunimin ushtarak midis dy vendeve, duke veçuar rolin e Kanadasë në trajnimin dhe arsimimin e personelit ushtarak shqiptar ndër vite.

"Vlerësoj kontributin e vyer të një vendi partner si Kanadaja, në përgatitjen e personelit ushtarak shqiptar dhe sot ne jemi krenar që shërbejmë krah për krah në operacione të përbashkëta në kuadër të Aleancës. Kontributi i



përbashkët që ne sot kemi në Grup-batalionin e Prezencës së Përpëruar të NATO-s në Letoni, është një dëshmi e qartë e bashkëpunimit që ne kemi", - u shpreh ndër të tjera gjeneralmajor Shehu. Gjithashtu, të dy bashkëbiseduesit ndanë shqetësimet lidhur me situatën e sigurisë në krahun lindor të Aleancës dhe vlerësuan nevojën e rritjes së bashkëpunimit në të ardhmen.

Bajram Begaj betohet në Kuvend si President i Republikës

Presidenti Begaj: Do të jem shërbëtor i popullit tim, përfaqësues i unitetit tonë kombëtar, mbështetës i palëkundur i rrugëtimit euroatlantik

Presidenti i ri i Shqipërisë, z. Bajram Begaj mori zyrtarisht detyrën, pas betimit në Kuvendin e Shqipërisë dhe ceremonisë në Presidencë.

Pas betimit mbi Kushtetutën e Shqipërisë, Begaj mbajti një fjalë përshëndetëse në Kuvend, ku theksoi se përgjegjësia që ai merr vjen në një moment historik për Shqipërinë e cila “ka hyrë në një rrugë të pakthyeshme europiane”.

“U betova sot se do t’i shërbej Kushtetutës, interesit kombëtar dhe përparimit të popullit shqiptar dhe të përmbush detyrën time sipas parimeve dhe normave të kushtetutës. Këtë mision do ta kryej mbi palët, por unë nuk do të qëndroj neutral ndaj asnjërit që bie ndesh me këtë betim, ndaj asnjërit që vendos interesat personale përpara interesave të kombit tonë”, - tha Begaj.

Ai shtoi se do të mbështesë bashkëpunimin mes të gjitha forcave politike, në gjetjen e gjuhës së përbashkët dhe se angazhimi i të gjithëve është “të kemi ndjenjën e përgjegjësisë dhe të respektojmë vendimet e organeve kompetente”.

Pas betimit, Begaj u drejtua drejt selisë së Presidencës së Shqipërisë, ku iu dorëzua detyra nga ish-presidenti Ilir Meta.

Pasi kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, Vitorë Tusha, i dorëzoi Presidentit Begaj Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, presidenti i ri i vendit mbajti një fjalë përshëndetëse, ku theksoi se do të jetë përfaqësues i unitetit kombëtar.

“Sot u betova për besnikëri ndaj Kushtetutës e ligjeve të vendit, për të respektuar të drejtat dhe liritë e shtetasve, për të mbrojtur pavarësinë e Republikës së Shqipërisë dhe për t’i shërbyer interesit të përgjithshëm dhe përparimit të popullit shqiptar”, - tha presidenti Begaj.

Presidenti Begaj shtoi më tej: “Do të jem shërbëtor i popullit tim, përfaqësues i unitetit tonë kombëtar, mbështetës i palëkundur i rrugëtimit euroatlantik për të gjithë shqiptarët e Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi, Luginës së Preshevës dhe kudo që ata jetojnë e punojnë”.



Urimi i ministrit të Mbrojtjes, Niko Peleshi, drejtuar presidentit Bajram Begaj

“**S**uksese Bajram Begajt në detyrën e Kreut të Shtetit! I bindur se do të shkemi një bashkëpunim të shkëlqyer edhe si Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura!” - do të uronte Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi në ditën e dekretimit të kreut të shtetit shqiptar, presidentit Bajram Begaj.



Në ambientet e garnizonit ushtarak “Skendërbej” u organizua ceremonia e diplomimit të KPO 2022. Të pranishëm në ceremoni ishin ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, zëvendësministria e Mbrojtjes Dallëndyshe Bici, drejtori i Shtabit të Përgjithshëm Bilbil Bitri, atashe ushtarakë të akredituar në vendin tonë, gjeneralë, komandantë, drejtues të FA-së, si dhe familjarë të studentëve, të cilët kishin emocionin e fëmijëve të tyre, të cilët tashmë do të jenë liderët e së ardhmes së afërt.

Komandant i AFA-së, gjeneral brigade Albert Mullai në fjalën e tij përshëndetëse me rastin e përfundimit të KPO 2022 theksoi: “Ju sfiduat një program mjaft cilësor me standarde të larta bashkëkohore. Me kënaqësi ju them se ju ja dolët!”

Gjeneral Mullai falënderoi pedagogët, instruktorët, drejtuesit për punën intensive dhe profesionale. Një falënderim tjetër ishte për familjet e studentëve që i mbështetën në zgjedhjen e tyre, për të qenë pjesë e Forcave të Armatosura.

“Me punë serioze dhe angazhim të palodhur krijuat kohezion duke arritur të jeni tashmë ushtarake me njohuri, aftësi dhe vlera, të gatshëm për të marrë përgjegjësi. Detyrat tuaja nesër do të jenë më të vështira dhe më komplekse dhe për këtë ju duhet të jeni gati. Ju tani e tutje nuk do jeni përgjegjës vetëm për veten tuaj por dhe për efektivët që do të drejtoni, ndaj punoni dhe përgatituni për të qenë liderët e së ardhmes.

Qeveria dhe Ministria e Mbrojtjes i kanë kushtuar një rëndësi të madhe arsimimit në FA, duke na orientuar drejt arsimimit më të mirë në botë, atij të “WEST POINT”, - do të citonte në fjalën e tij komandanti i AFA-së gjeneral brigade Albert Mullai.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi në fjalën e tij të rastit, pasi përshëndeti të pranishmit dhe uroi studentët për përfundimin me sukses të këtij rrugëtimi të vështirë dhe plot sfida, u shpreh se: “ishte i lumtur që Forcave të Armatosura i shtohen edhe 54 oficerë të rinj, ku 29 janë vajza dhe 25 djem, të arsimuar më parë në universitete civile, të cilët ndoqën për rreth



Zhvillohet ceremonia KPO 2022

Ministri Peleshi: Në emër të popullit shqiptar, familjarëve tuaj, iu dërgoj një falënderim dhe iu përulem për edukimin e tyre, të këtij brezi ushtarakësh kaq të rëndësishëm për Shqipërinë



1 vit Kursin e Përgatitjes së Oficerit dhe tashmë do të shërbejnë si oficerët më të rinj të FA-së. Ata bëhen pjesë e kësaj armate në një moment kur Forcat e Armatosura, figura e ushtarakut në Shqipëri, në Europë dhe në gjithë botën ka marrë një vëmendje të veçantë. E gjithë shoqëria ka kthyer kokën, ka

vendosur besimin dhe shpresën për një të nesërme më të mirë, më të paqtë tek figura e ushtarakut, tek Forcat e Armatosura.” Më tej, ministri Peleshi do vijonte fjalën e tij: “Sot ju do të vendosni simbole të reja, çka do të thotë dhe përgjegjësi të reja, përgjegjësi ndaj atdheut, përgjegjësisë ndaj detyrës më

të shenjtë dhe më të lartë që një qytetar mund të ketë në jetën e tij. Sot ju do titulloheni oficerë, ka disa arsye pse jeni ju dhe jo kushdo tjetër, sot oficer ju ka bërë kuraja dhe sakrifica individuale, por dhe përkushtimi i profesorëve dhe komandantëve tuaj, ndaj të cilëve ndjej mirënjohje dhe falënderim për gjithë pu-

nën e tyre të madhe. Jo të gjithë e kanë të thjeshtë të ndër marrin një nismë të tillë, të vetë mohohen në raste të caktuara. Në emër të popullit shqiptar, gjithë familjarëve tuaj iu dërgoj një falënderim dhe iu përulem për edukimin e tyre, të këtij brezi ushtarakësh kaq të rëndësishëm për Shqipërinë”.

Ekipi i Akademisë “West Point”, vizitë në Akademinë e Forcave të Armatosura

Në kuadër të riorganizimit dhe modernizimit të Akademisë së Forcave të Armatosura, sipas modelit të Akademisë Ushtarake të “West Point” të SHBA-ve, një grup pedagogësh nga Akademia Ushtarake e “West Point” zhvilloi një vizitë pune në Akademinë e Forcave të Armatosura.

Qëllimi i vizitës ishte diskutimi dhe përgatitja e draft-programeve mësimore (kurrikulave) për programet e ciklit Bachelor, që Akademia e Forcave të Armatosura ka planifikuar të hapë për vitin akademik 2023-2024 e në vijim, metodat e mësimdhënies, praktikat më të mira të trajnimit të mësuesve si dhe çështje të tjera me interes reciprok.



Programet Bachelor do të kenë një kohëzgjatje 4-vjeçare dhe në fokus të saj do të kenë krijimin e drejtuesve me integritet, të pajisur me aftësi të plota në fushën ushtarake, në fushën akademike si dhe të

përgatitur fizikisht për t'i shërbyer vendit si oficerë në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Bashkëpunimi me Akademinë Ushtarake Amerikane të “West Point” do të vijojë të intensifiko-



het në vijim me synim jo vetëm rritjen tonë cilësore drejt standardit më të lartë të përgatitjes së oficerëve por edhe

përafrimin e gjithë metodologjisë e frymës së përgatitjes sipas modelit Amerikan.



Grup-Batalioni i KëmbëSORISË së Lehtë përfundon me sukses trajnimin në Fort Drum, SHBA, si pjesë e stërvitjes “eX-portable Combat Training Ca-pability”, me batalionin 2-113 të Brigadës së 44-t të Gardës Kombëtare të New Jersey-it.



Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Arben Kingji, inspekton zhvillimin e stërvitjes së përbashkët mes forcave speciale shqiptare dhe forcave speciale amerikane, “JCET-22”



Prej orëve të para të mëngjesit, Forca Tokësore është angazhuar në dy operacione për fikje zjarri me b1k në Malësinë e Madhe dhe me b3k në Berat.



Ekipi i snajperëve të Grup Batalionit të KëmbëSORISË së Lehtë, zhvillon trajnimin e qitjeve me snajper në Fort Drum, SHBA, për mbrojtjen e rajoneve të përkohshme të përqendrimit, nga elementë të rrezikshëm “hostile”.



Forca **AJRORE**

Helikopteri "Cougar" me ekuipa-
zhet e pilotëve dhe teknikëve në
bord kryen misionin e ndërhyrjes
nga ajri për shuarjen e zjarrit në

njësinë administrative Zejmen në Lezhë. Operacionet nga
ajri, gjatë ditës janë kryer mbi sipërfaqe pyjore pranë zonës
së mbrojtur në Bërzanë, duke bërë të mundur eliminimin e
vatrës së zjarrit në pyjet e këtij rajoni nëpërmjet hedhjes së
ujit me kovën e posaçme "Bambi Bucket".

Helikopteri "Cougar" shuan vatrat e zjarreve që rrezikonin zonën e mbrojtur të pyjeve Berzanë, Lezhë



Helikopterët e Forcës Ajrore kryen ambulanca ajrore në Vlorë dhe në Tropojë

Ekuipazhi i helikopterit të transportit të shëndetësisë EC dhe ekuipazhi i një-
sisë së RENE-s kryen operacione fluturuese në një kohë të shpejtë, në një
teren të vështirë. Misioni i parë kreu një operacion fluturues, përkatësisht:
ambulancë ajrore në Vlorë, duke transportuar dy pacientë nga Palasa drejt
Spitalit të Traumës, në Tiranë.

Misioni i dytë kreu një operacion fluturues në Valbonë, Tropojë, duke transportuar
personel mjekësor dhe efektivë të Policisë së Shtetit drejt vendit "Maja e Grykave".

Misioni i tretë kreu një operacion fluturues, përkatësisht: ambulancë ajrore në Val-
bonë, Tropojë, duke transportuar të sëmurë nga vendi i quajtur "Maja e Grykave", drejt
spitalit të qytetit të Shkodrës.



Prej disa ditësh, 40 efektivë, 2
mjete zjarrfikëse dhe 1 autoam-
bulancë janë aktivizuar nga BMEC
për të kryer operacionet e fikjes së
vatrave të zjarrit. Që në ditën e parë
të aktivizimit të zjarreve u desh të
veprohej në dy zona njëkohësisht, në
Krastë të bashkisë Krujë dhe Orosh të
bashkisë Mirditë.

Era e fortë dhe terreni malor e
bënin të vështirë kryerjen e detyrës nga
efektivat BMEC. Në këto terrene u
punua dhe natën për të bërë të mundur
krijimin e brezave për parandalimin e
përhapjes së zjarrit dhe eliminimin e
vatrave të krijuara.

Sfidë për efektivat e BMEC në
fikjen e zjarrit ka qenë zona e Ball-
drenit, ku zjarri arriti në afërsi të
zonave të banuara. U desh ndërhyrja
e zjarrfikëses, që bëri ndalimin e vër-
shimit të zjarrit në shtëpitë rrëzë malit.
Erës së fortë dhe terrenit të thepisur
iu shtuan dhe plasjet e municioneve
luftarake, që aktivizoheshin nga zjarri.
Me përkushtim dhe masa të shtuara
sigurie u bë i mundur eliminimi i
shumë vatrave të zjarrit dhe kthimin
e situatës në normalitet.

Trupat zjarrfikëse të BMEC, në gatishmëri për t'iu përgjigjur thirrjes në përballimin e emergjencave civile





Forca Detare, pjesë e operacionit në ndjekjen e gomones që dyshohej për transportimin e lëndëve narkotike

Prej konstatimit të bërë nga helikopteri i misionit "Frontex" se një mjet lundrues "gomone" në veriperëndim të ishullit grek Othonoi po lëvizte me shpejtësi të 40 nyje. Roja Bregdetare (RB), Policia e Migracionit dhe Kufirit (PKM) si dhe Delta Forcës (DF), të cilat ishin në gatishmëri në Porto-Palermo, Himarë, Sazan dhe Vlorë u vunë në ndjekje.

Për më shumë se 14 orë dhe 200 milje detare të përshkuara ka zgjatur operacioni në ndjekje të mjeti lundrues i dyshuar se transportonte lëndë narkotike.

Operacioni për ndjekjen dhe bllokimin e gomones është kryer në bashkëpunim me Policinë Kufitare dhe të Migracionit, misionin e Bashkimit Europian "Frontex", Delta Forcës dhe Guardia di Finanza-s. Ndjekja e mjeti të dyshuar është bërë përgjatë gjithë bregdetit shqiptar duke angazhuar në



operacion anije nga vendbanimi i ishullit të Sazanit, Durrësit dhe Shëngjinit. Forca Detare ka marrë pjesë në këtë operacion me tre anije duke bërë ndjekjen e objektit nga momenti i diktimit në rajonin e jugut deri në kufirin me Malin e Zi. Ndjekja e objektit është kryer në

kohë reale edhe nëpërmjet Sistemit të Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Detare (SIVHD).

Anija P-134 "Lissus" ka shërbyer si nyje koordinuese midis mjeteve ajrore të "Frontex" (një helikopter dhe një avion) dhe forcave të tjera pjesë-



marrëse si dhe me anë të kamerave termike ka bërë diktimitin e objektit disa herë gjatë ndjekjes. Operacioni është koordinuar edhe me Qendrën Operacionale të Malit të Zi, me të cilën janë shkëmbyer informacione në kohë reale për vendndodhjen,

drejtimin dhe shpejtësinë e objektit të dyshuar. Pas përpjekjeve të dështuara për t'iu shpëtuar forcave të zbatimit të ligjit, mendohet se mjeti i dyshuar është mjeti i cili është gjetur nga forcat e PKM i braktisur dhe në zonën e Patokut, në gjirin e Drinit.

Në rajonin e gjirit të Vlorës u zhvillua Stërvitja "Antindotja - 2022", e cila është një nga aktivitetet kryesore të Forcës Detare. Kjo stërvitje u zhvillua në bashkëpunim edhe me Institucionin e Prefektit të Qarkut Vlorë, Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare, "La Petrolifera Italo - Albanese", Agjencinë Rajonale të Mjedisit, Kapitanerinë e Portit Detar, Vlorë.

Stërvitja kishte si qëllim trajnimin, stërvitjen e efektivëve të anijeve (kryesisht të anijes speciale antindotje) për përdorimin e pajisjeve, mekanizmave, mjeteve dhe teknikave të reagimit ndaj ndotjeve detare. Gjithashtu fokusi i kësaj stërvitje ishte përmirësimi i koordinimit midis institucioneve me interesa në det, në përgjigje të emergjencave civile, ndaj ndotjeve detare si dhe testimi i kapaciteteve reaguese të Flotiljes Detare. Në stërvitje morën pjesë dy anije të Flotiljes Detare: anija speciale antindotje "Karaburuni Y-32" dhe anija "Oriku P-132", si edhe një gomone e anijes së klasit "Iliria P-132".

Stërvitja u ndoq dhe vlerësua nga Shtabi i Flotiljes Detare nën drejtimin e komandantit të Flotiljes Detare Pashaliman, kapiten i rangut I Engjëll Sinanaj.

Gjatë zhvillimit të "DVDay" të stërvitjes "Antindotja 2022" ishte pjesëmarrës dhe komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agas-



tra, kryetari i Bashkisë Vlorë Zoti Dritan Leli, përfaqësues të Institucionit të Prefektit të Qarkut Vlorë, "La Petrolifera Italo - Albanese", të QNOD, për-

faqësues të Njësisë Speciale të Kufirit dhe Migracionit "Delta", Agjencisë Rajonale të Mjedisit dhe Agjencisë së Zonave të Mbrojtura.

Zhvillohet stërvitja "Antindotja - 2022"



Në përfundim të stërvitjes komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra falënderoi efektivët për përgatitjen, angazhimin dhe profe-

sionalizmin e treguar gjatë zhvillimit të stërvitjes si dhe falënderoi përfaqësuesit e strukturave pjesëmarrëse në këtë aktivitet.

Përshtati: MIMOZA GOLIKJA

Mbrojtja e civilëve në konflikt, emergjencë etike dhe strategjike

Mbrojtja e civilëve në konflikt, nuk ndryshon me ndryshimin e mjedisit të sigurisë. Ajo është një emergjencë etike dhe strategjike, por edhe një faktor vendimtar në planifikimin, zhvillimin dhe vlerësimin e operacioneve ushtarake. Strategjia dhe planifikimi i NATO-s për të ardhmen e ka domosdoshmëri pasqyrimin e këtij realiteti në dokumentet e saj.

Ndërsa liderët e vendeve të NATO-s u takuan në Samitin e Madridit në qershor 2022, mjedisi i sigurisë në të cilin u zhvillua ky Samit ishte shumë i ndryshëm nga ai që formësoi Konceptin Strategjik të dekadës së kaluar. Përcaktimi i Konceptit Strategjik të vitit 2010, se zona euroatlantike është në paqe dhe kërcënimi i një sulmi konvencional kundër territorit të NATO-s është i ulët”, nuk vlen më. Aneksimi i paligjshëm i Krimesë nga Rusia në vitin 2014, lufta e saj hibride afatgjatë kundër Ukrainës dhe më në fund sulmi i gjithanshëm në shkurt 2022, tashmë e kanë kthyer spektrin e luftës konvencionale dhe konfrontimin e mundshëm të fuqive të mëdha në politikën europiane. Kërcënimet hibride, goditjet e energjisë, rritja e çmimeve të ushqimeve dhe pasojat ekonomike dhe sociale të pandemisë komplikojnë më tej mjedisin tashmë kompleks të sigurisë.

Në shumicën e luftërave, civilët janë ata që paguajnë çmimin më të lartë. Kombet e Bashkuara vlerësojnë se 100 civilë vdesin në konfliktet çdo ditë. Midis viteve 2001-2021, 387 000 civilë mendohej se kanë humbur jetën si rezultat i drejtpërdrejtë i armiqësive në luftërat e pas 11 shtatorit, dhe shumë të tjerë kanë vuajtur nga efektet indirekte të luftës, siç është shkatërrimi i infrastrukturës kritike. “Në 100 ditët e para të luftës intensive në Ukrainë, ndërsa Federata Ruse kaloi nga përdorimi i armëve pa dallim në shënjestrimin e qëllimshëm të civilëve dhe infrastrukturës civile, 4 339 civilë u vranë dhe 5 246 u plagosën”. Por këto shifra, thotë dr. Karolina MacLachlan, Këshilltare e Lartë, në Qendrën për Civilët në Konflikt, nuk përfshijnë me sa duket, viktimat shumë më të larta civile që nuk mund të konfirmoheshin. “Pas 100 ditësh luftimesh, pothuajse 5 milionë ukrainas u bënë refugjatë në Europë dhe mbi 7 milionë u zhvendosën brenda vendit. Vrasjet arbitrare, mungesa e aksesit në infrastrukturën kritike dhe dhuna seksuale kanë qenë përvoja e jetuar e shumë njerëzve”.

Mbrojtja e civilëve është një aspekt kyç i luftës dhe një urgjencë etike dhe strategjike në të gjitha llojet e konflikteve, nga lufta hibride deri të kundërrebelimit dhe operacionet ushtarake në shkallë të gjerë, ku kundërshtari mund të përdorë taktika të dizajnuara për të shkaktuar dëme civile. Gati dy dekada të operacioneve ushtarake dhe asistencës së forcave të sigurisë në Afganistan dhe Lindjen e Mesme kanë konfirmuar se ulja e dëmit civil është një kusht i domosdoshëm që operacionet ushtarake dhe partneritetet e sigurisë të kenë sukses. Kur nuk pranohen dhe nuk adresohen, dëmi civil tenton të përforcojë perceptimet negative të forcave të armatosura, krijon sfida për mbrojtjen e forcës dhe nxit mosbesim dhe radikalizim. Lufta në Ukrainë sugjeron që në skenarët e Nenit 5 për NATO-n, aksionet do të ishin edhe më të larta. Mbrojtja e civilëve nga veprimet e të tjerëve dhe zbutja e dëmeve që vijnë nga operacionet e veta do të jetë çelësi i mbrojtjes së suksesshme. Sa më mirë të mbrohen civilët, aq më i madh është elasticiteti dhe mbështetja e tyre për stabilizim dhe paqe të qëndrueshme.

Nëse forcat e armatosura ndërtojnë themelet e ofruara nga “E Drejta Ndërkombëtare Humanitare” dhe mirato-



jnë masa mbrojtëse të forta në operacionet e tyre të përditshme, ato mund të zbusin dëmet civile që vijnë nga operacionet e tyre dhe mund të mbrojnë civilët nga veprimet e kundërshtarëve. Gjatë misionit të Forcave Ndërkombëtare të Asistencës për Sigurinë (ISAF) në Afganistan, aleatët zbatuan zgjidhje novatore për të zbutur dëmin e civilëve; NATO miratoi një Politikë për Mbrojtjen e Civilëve gjatë Samitit të Varshavës 2016, e ndjekur nga një koncept ushtarak (2018), një manual zbatimi (2020) dhe një seri ushtrimesh që synojnë testimin e forcave të NATO-s. Meqenëse Politika është bazuar kryesisht në zbutjen “në luftën kundër rebelimit, megjithatë, është më pak e qartë se rëndësia e saj për operacionet e mundshme të Nenit 5 është kuptuar ose funksionalizuar mirë”.

Prandaj Koncepti Strategjik i vitit 2022 është kështu një mundësi e veçantë për të siguruar që angazhimi për Mbrojtjen e Civilëve, rithekos dhe siguron udhëzime të forta politike për të mbështetur zbatimin. Duke pasur parasysh paparashikueshmërinë e situatës së sigurisë në Europë, “është e domosdoshme që NATO dhe aleatët individualë të plotësojnë angazhimin e tyre të bazuar në vlera për të mbrojtur civilët me udhëzime politike, doktrinë ushtarake, procedura standarde operative dhe trajnim. Qëllimi përfundimtar është t’u mundësojë vendeve të NATO-s, si dhe forcave të caktuara për Aleancën, nga Forca e Reagimit të NATO-s në Korpusin Shumëkombësh në Veri-Lindje dhe elementët e Prezencës së Përpunuar të Përmirësuar, të zbusin dëmin në operacionet e tyre dhe të mbrojnë civilët nga veprimet e të tjerëve. Ndërsa Koncepti i Ri u miratua, pjesa më e madhe e punës së mbrojtjes bëhet tashmë në institucionet e NATO-s dhe qeveritë aleate. Koncepti është kyç për nxitjen e konsensusit, ofrimin e udhëzimeve mbi tendencat përkatëse dhe identifikimin e prioritetëve dhe drejtimeve për punë të mëtejshme.

Tendencat aktuale në mbrojtjen e civilëve

Planifikimi i NATO-s merr në konsideratë katër tendenca kyçe që ka të ngjarë të formësojnë Mbrojtjen e Civilëve në dekadat e ardhshme. Ringjallja e luftës së fuqive të mëdha me intensitet të lartë sjell me vete kërcënim të përshkallëzimit. Konfliktet që përfshijnë fuqitë e mëdha nuk janë më një kujtim i largët, përkundrazi, ato janë bërë një rrezik për t’u përballur. “Ndërsa përgatiten të përforcojnë mbrojtjen në krahun lindor, aleatët do të duhet të marrin në konsideratë PoC si një element kyç të strategjisë së tyre dhe një faktor në formësimin e qëndrimit të forcës. Ata do të duhet të marrin parasysh qëndrimet e ‘mbrojtjes totale’ të shteteve baltike dhe implikimet për PoC të mund të kenë këto, të marrin parasysh lëvizjet në shkallë të gjerë të njerëzve dhe të

zbatojnë njohuritë dhe praktikën e PoC të fituara në operacionet ekspeditive në terren në vendin e tyre”, - sugjeron dr. MacLachlan.

Nëse konfliktet përshkallëzohen, konfrontimi i fuqive të mëdha mund të përkeqësohet nga lufta urbane, lufta në Ukrainë sugjeron se vlera strategjike e qyteteve dhe roli i tyre në mundësimin e jetës së një vendi mund të sjellë ‘luftime në rrugë’. Terreni kompleks, duke përfshirë nëntokën, vështirësia për të dalluar midis civilëve dhe kundërshtarëve ushtarakë, afërsia e objektivave ushtarake me infrastrukturën civile, ndërlikimet në mbajtjen e komandës dhe kontrollit efektiv dhe një kohë e ngjeshur reagimi i bëjnë qytetet territor sfidues për ushtarakët. Për civilët, dëmet që vijnë nga përdorimi i armëve shpërthyes në zonat e populluara dhe efektet nga shkatërrimi i infrastrukturës, nga spitalet te termocentralet, mund t’i bëjnë qytetet të pajetueshme. Ky është veçanërisht rasti nëse një kundërshtar kryen sulme pa dallim ose synon qëllimisht civilët. Në Ukrainë, forcat e Federatës Ruse thuhet se kanë granatuar objekte civile, vende të rrezikuara bërthamore dhe u kanë mohuar civilëve kalimin e sigurt nga zonat e konfliktit.

Nën pragun e operacioneve kinetike të plota, lufta hibride është bërë pjesë integrale e arsenalit të fuqisë së madhe. I përdorur për të mbjellë mosbesim dhe për të krijuar kushte ku konfliktet janë më të vështira për t’u dhënë fund, shpesh përfshihet një element i rëndësishëm i luftës informative pasi viktimat civile mund të manipulohen, armatosen dhe përdoren për të dominuar hapësirën e informacionit. Hulmimet fillestare në luftën e Ukrainës tregojnë gjithashtu se taktikat e dezinformimit mund të rezultojnë në dëmtim fizik pasi ato formojnë përgjigjet dhe vendimet individuale.

Së fundi, luftërat civile mund të mbeten forma më e spikatur e konfliktit në nivel global. Sjellja e ashpër e forcave të sigurisë dhe aktorëve jo shtetërorë mund të rezultojë në cikle dhune kundër civilëve, duke zgjatur konfliktin dhe duke e shtyrë zhvillimin me dekada. Përfshirja e shpeshtë e aktorëve të jashtëm, qoftë nëpërmjet ndihmës për sigurinë apo përdorimit të Kompanive Private Ushtarake (PMC) që kryejnë detyra ushtarake dhe të lidhura me sigurinë në konflikte dhe kontekste të brishta, mund të komplikojë fushën e betejës dhe ta bëjë më të vështirë vendosjen e përgjegjësisë. Aktiviteti i PMC mund të përkeqësojë rreziqet për civilët dhe, për shkak të pranisë së aktorëve të shumtë me zinxhirë të paqartë komandimi dhe kontrolli, e bën më të vështirë mbajtjen e dikujt përgjegjës për abuzimet në luftë.

Si t’i jepet përparësi mbrojtjes së civilëve

Duke pasur parasysh rreziqet në rritje dhe dobësitë akute të civilëve ndaj efekteve të konfliktit brenda dhe jashtë territorit të NATO-s, NATO tani ka një mundësi unike për të përsëritur angazhimin politik për Mbrojtjen e Civilëve dhe për të nxjerrë një mandat dhe udhëzim të fortë për zbatimin që do të çojë në “Mbrojtjen si prioritet në NATO dhe institucionet kombëtare”. Kjo duhet të bëjë që vendet anëtare dhe institucionet e Aleancës t’i japin përparësi Mbrojtjes në tre dimensione kryesore: Si një urgjencë bazuar në vlera për një Aleancë që synon të mbrojë vendet dhe njerëzit aleatë; Si një komponent i domosdoshëm i strategjisë efektive që u mundëson forcave të armatosura të mbështesin objektivat politike duke mbrojtur civilët nga efektet më të këqija të konfliktit; dhe Si një komponent kyç i qëndrueshmërisë së një vendi.

Angazhimi politik, megjithatë, duhet të jetë vetëm fillimi i rrugës dhe një mandat për zbatim. Nga ana praktike, ka disa veprime kyçe që forcat e NATO-s mund të ndërmarrin për t’u përgatitur për armiqësitë e mundshme në terrenin e brendshëm dhe proceset e reja që mund të ndihmojnë në përkthimin e angazhimit politik në procedura dhe asete ushtarake. NATO ka një mundësi për t’i vënë në zbatim”.

Sipas dr. Karolina MacLachlan, para së gjithash, për të mbrojtur në mënyrë efektive dhe për të zbutur dëmet që vijnë nga veprimet e veta, NATO dhe qeveritë aleate duhet të bisedojnë me civilët, në një mënyrë rutinë dhe kuptimplotë. Kjo duhet të përfshijë zhvillimin e aftësive, procedurave, kanaleve të komunikimit dhe zakoneve proaktive të përfshirjes së komunitetit dhe shoqërisë civile në luftë, të cilat të gjitha mund t’i ndihmojnë forcat e armatosura të kuptojnë mjedisin e tyre operacionale dhe efektin e pranisë dhe operacioneve ushtarake mbi civilët, dhe të parashikojnë më mirë sjellje në konflikt. Angazhimi i komunitetit, “i kryer jashtë syve”, ku lidhje të tilla mund të rrezikojnë civilët është gjithashtu thelbësor nëse forcat e armatosura shpeshojnë të sigurojnë dhe të ruajnë mbështetjen e civilëve në zonat e tyre të operimit. Në kohë paqeje, vendet jo anëtare të NATO-s, duke përfshirë autoritetet civile dhe organizatat e shoqërisë civile, mund të jenë partnerë të vlefshëm në dialogun, planifikimin dhe ushtrimet e vazhdueshme, veçanërisht për institucionet e NATO-s dhe aleatët që ka të ngjarë të preken më shumë nga situata në zhvillim e sigurisë, duke përfshirë shtetet e Baltikut, Poloninë dhe aleatët që kontribuojnë në Prezencën e Përpunuar të Përfuruar.

Së dyti, Aleanca duhet të përdorë maksimalisht proceset që ka në dispozicion, Procesin e Planifikimit të Mbrojtjes së NATO-s (NDPP), Planet e Reagimit të Diplomuar (GRPs) dhe arkitekturën e gjerë të ushtrimeve, për të siguruar që aftësitë e nevojshme për të mbrojtur civilët (mjetet e inteligjencës, trajnimi për trupat, burimet për njësitë e CMI) merren po aq seriozisht sa ato që mundësojnë luftime dhe se standarde të forta janë miratuar në të gjithë aleancën. Këto procese mund të ndihmojnë në promovimin e pranimit të praktikave të mira në zhvillim në mbrojtje, përfshirë qelizat e gjurmimit të dëmeve civile (CHT) të zhvilluara dhe testuara nga ISAF në Afganistan. Të ngulitura në planifikim, me burime të mira dhe të testuara në ushtrime, CHT-të mund të gjurmojnë dhe analizojnë rastet

e dëmtimit civil dhe të rekomandojnë modifikime taktike dhe operacionale për të reduktuar, parandaluar dhe zbutur incidentet civile. “Kombet duhet gjithashtu të marrin në konsideratë krijimin e procedurave që mundësojnë përgjigjen ndaj dëmtimeve civile, nga ndihma mjekësore deri të ndryshimi i mekanizmave, të cilat jo vetëm që mund të ndihmojnë në zbutjen e dëmeve, por gjithashtu ndihmojnë në kultivimin e marrëdhënieve më të mira civilo-ushtarake.

Së treti, aleatët do të duhet të zhvillojnë dhe të komunikojnë qasje ndaj konflikteve, ku civilët dhe infrastruktura civile mund të synohen qëllimisht; përvojat nga Siria dhe Ukraina sugjerojnë se ky është një skenar i mundshëm. Kjo do të kërkojë që forcat aleate të përgatiten për situata në të cilat mbrojtja e civilëve nga veprimet e të tjerëve bëhet prioritet dhe të jenë në gjendje të formësojnë operacionet ushtarake, mbledhjen e inteligjencës dhe ndërlidhjen me vendet jo anëtare të NATO-s në mënyra që mundësojnë paralajmërimin e hershëm dhe të fuqishëm civil, koordinimi ushtarak.

Së katërti, rritja e rëndësisë së gatishmërisë për operacionet e Nenit 5 nuk do të thotë se aleatët duhet të humbasin nga sytë ndihmës e forcave të sigurisë, duke përfshirë edhe kontekstet kundër terrorizmit.

Partneritetet bashkëpunuese të NATO-s për sigurinë kanë ofruar tashmë rrugë për të nxitur miratimin e standardeve të fuqishme të Mbrojtjes midis vendeve partnere. Përvojat e fundit dhe zgjidhjet inovative të zbatuara nga partnerët, si dhe mësimet nga lufta në Ukrainë, si për llojet ashtu edhe për përgjigjet ndaj dëmtimeve civile, duhet të përfshihen në paketat e partneritetit të NATO-s për të përfituar nga gatishmëria e të tjerëve”.

Ndërsa mjedisi i sigurisë evoluon dhe NATO përballat me sfida të reja, rëndësia e Mbrojtjes së Civilëve në konflikt mbetet konstante. Një grup rrethanas të reja sjell me vete tundimin për t’u përgjigjur në mënyra të reja dhe përgatitjet për mbrojtjen territoriale mund të duken shumë të ndryshme nga ato për menaxhimin e krizave ekspeditive. Por parimi kryesor është i njëjtë, “Mbrojtja e Civilëve nuk është thjesht diçka që forcat e armatosura bëjnë së bashku me aktivitetin e tyre kryesor të luftimeve, por më tepër një komponent thelbësor i planifikimit dhe operacioneve ushtarake, dhe një aftësi kyçe që NATO duhet t’i japë përparësi”. Dy dekadat e fundit të operacioneve aleate ofrojnë një mori praktikash dhe qasjesh mbi të cilat “NATO mund të ndërtojë ndërsa riorienton qëndrimin e saj drejt Europës, dhe proceset e vazhdueshme brenda Aleancës, nga Koncepti i ri Strategjik deri te puna për qasjet ndaj sigurisë njerëzore dhe hapat e ardhshëm, në zbatimin e Mbrojtjes së Civilëve janë mundësi për të integruar konsideratat e Mbrojtjes në të gjitha rrugët e veprimit të NATO-s”.

Mbrojtja nuk është diçka që mund të përfshihet në momentin e fundit, përkundrazi, ajo ka nevojë për qasje të testuara mirë, mendësi mbështetëse dhe aftësi të qëndrueshme që do t’i lejojnë forcat e NATO-s të kuptojnë se si të mbrojnë dhe mbështesin më së miri civilët. Ky është një investim që jo vetëm do të ndihmojë në përbushjen e detyrimeve etike të forcave, por edhe do të forcojë qëndrueshmërinë dhe do ta bëjë më efektiv bashkëpunimin civilo-ushtarak. Në një epokë të pasigurt, është edhe më e rëndësishme që ky investim të ketë prioritet.

ZHYTJE NË THELLËSI TË DETIT ADRIATIK

Forcat speciale kroate dhe "Navy SEAL" të SHBA-së, në stërvitje të përbashkët

Forcat e Operacioneve Speciale të NATO-s duhet të jenë vazhdimisht në gjendje të trajtojnë detyrat më komplekse në mjediset më të vështira, që nga ngjitja në anën e një anijeje ndërsa ajo është nën zjarr e deri tek zhytja në thellësi të detit.

Forcat speciale kroate testuan këtë javë, aftësitë e tyre detare gjatë një stërvitjeje të përbashkët me Navy SEAL të SHBA-së në detin Adriatik. Edhe pse varkat ishin të vogla, ato vepruan me shpejtësi, sipas skenarit të stërvitjes ndërsa shpërhapnin valët e bardha në nisjen e tyre nga qyteti kroat i Splitit. "Në bordin e anijes rrëmbyesit, improvizuar nga ushtarët kroatë, zënë pozicionet e qitjes. Ishin katër prej tyre dhe ata u goditën me një forcë të kombinuar sulmi të operatorëve të Forcave Speciale Kroate dhe SEAL-ve të marinës amerikane. Rrëmbyesit qëllonjë. Por barkat e gomës, secila e mbushur me tyta pushke, afrohen. Brenda pak sekondash, operatorët kroatë i lidhin shkallët pas anijes dhe i ngulin në bord. SEAL hipin nga skaji dhe vrapojnë për në dhomën e motorit, pushkët e tyre drejtohen përpara dhe mbrapa nëpër kuvertë, ndërsa operatorët bëjnë një ngjitje 10 metra për të marrë urën. Brenda pak minutash, ata kapin kontrollin e anijes, neutralizojnë armiqet e tyre dhe kanë disa objektiva me vlerë të lartë". Ky ishte skenari i zhvilluar gjatë stërvitjes. Pastaj pas komandës "ENDEX!", stërvitja mbaron. Ata që ishin 'rrëmbyesit' largohen nga kuverta dhe komandot grumbullohen në skajin e anijes për një rishikim të shpejtë të veprimeve.

Për Forcat e Operacioneve Speciale të NATO-s, këto angazhime dypalëshe stërvitore janë një moment i mirë për të shkëmbyer shënime mbi taktikat dhe pajisjet më të fundit. Për Komandën e Forcave Speciale Kroate (ZSS) në mënyrë specifike, si një njësi operacionesh speciale relativisht e re, aftësia për t'u stërvitur së bashku me Navy SEAL është dëshmi se sa shumë janë zhvilluar ata që nga fillimi i tyre në 2000 si Batalion i Operacioneve Speciale. "Forcat e Armatosura Kroate janë vigjilente dhe të gatshme të marrin pjesën e tyre të barrës dhe përgjegjësisë në mbrojtjen kolektive, si të Aleancës, aleatëve dhe partnerëve," - tha admiral Robert Hranj, shefi i Shtabit të Përgjithshëm kroat. Më vonë, ZSS dhe SEAL, vazhduan në pjesën tjetër të stërvitjes. Ata veshën kostumet nënujore dhe rrëshqitën në Adriatiku e ftohtë për notim nënujor në distanca të gjata dhe infiltrim të simuluar në plazh. Duke përdorur 'rebreathers' pa fluska, shumë më të fshehta se pajisjet SCUBA të njohura nga turistët, ata rrëshqitën disa metra nën ujë, të padukshëm nga sipërfaqja. Kur arritën objektivin e tyre, qëndruan në thellësi, për të vendosur krahët dhe për të përgatitur armët e tyre. Me syzet e vendosura ata eksploruan sipërfaqen e ujit dhe skanuan 'bregun armik'. Pastaj, si një mirazh, së bashku komando kroate dhe forca të marinës së SHBA-së u ngritën nga uji, duke u zvarritur me kujdes mbi dallgë, ndërsa uji pikonte nga pushkët e tyre. Në një operacion të vërtetë ushtarak, ky do të ishte momenti i cënueshmërisë më të madhe. Të zhytur në ujë, të ngarkuar me pajisje dhe duke u larguar jashtë mbulimit, komandot



janë plotësisht të ekspozuar. Por ata u zhytën sërish nën një dalje gurësh gëlqerorë, me pushkët e ngritura sipër gati për kërcënime të tjera.

Në një ushtrim tjetër, operatorët kishin për detyrë të kapin një urë. Për këtë, ata tërhoqën një shtyllë të gjatë, në krye si të një grepi masiv, që e përdorën për të siguruar shpejt një "shkallë litari të gjatë". Më pas operatorët ngjiten në shkallë një nga një, në heshtje ndërsa tërhoqën me vete pajisjet e tyre të rënda nga pesha relative e ujit të Adriatikut të kripur.

Komandanti i ZSS majror "Marko" (pseudonim për të mbrojtur identitetin e tij) thotë se është e rëndësishme që njësitë e operacioneve speciale të zhvillojnë një aftësi të fuqishme detare në mënyrë që të mund të operojnë në afërsisht 70 për qind të globit të mbuluar nga uji i detit. "Uji do të bëhet këndi ynë i lojërave." Hapi tjetër, shton ai, do të jetë që ZSS të integrojë më mirë lëvizshmërinë ajrore me misionet detare, që do të thotë se operatorët e tij mund të presin të shpenzojnë shumë më tepër kohë duke u zhytur në det nga helikopterët.

Për admiralin Hranj, trajnimi së bashku me Forcat e tjera të Operacioneve Speciale është një hap i dobishëm drejt bërjes më të sigurt të Kroacisë dhe Aleancës. "Duke pasur parasysh ngjarjet rreth nesh, në botë, veçanërisht në Ukrainë, ky është një kontribut i vogël për unitetin politik dhe gatishmërinë për bashkëpunim në mbrojtje të aleatëve, aleancave dhe partnerëve", - thotë ai.

Ndërveprueshmëria, forcat lidhëse

Po si funksionon një aleancë prej 30 vendesh në mënyrë efektive së bashku në operacione të përbashkëta? Ndërveprueshmëria, është ajo që i ndihmon të gjitha pjesët të përshtaten së bashku dhe të funksionojnë pa probleme. NATO është përpjekur të përmirësojë aftësinë e forcave të saj për të punuar së bashku që nga themelimi i Aleancës në 1949. NATO e përkufizon "ndërveprimin" si aftësinë e aleatëve për të vepruar së bashku në mënyrë koherente, efektive dhe efikase për të arritur objektivat taktike, operacionale dhe strategjike. Në mënyrë të veçantë, ndërveprimi u mundëson forcave, njësitë dhe sistemeve të veprojnë së bashku, duke i lejuar ata të ko-

bashku dhe me partnerë në çdo mjedis.

Forcat e Operacioneve Speciale

Forcat e Operacioneve Speciale të NATO-s (SOF) ofrojnë aftësi që plotësojnë ato të forcave ajrore, detare dhe tokësore të NATO-s dhe janë të rëndësishme në të gjithë gamën e operacioneve ushtarake. Këto aftësi SOF janë gjithashtu të zbatueshme për detyrat kryesore të Aleancës për mbrojtjen kolektive, menaxhimin e krizave dhe sigurinë bashkëpunuese. Shtabi i Operacioneve Speciale të NATO-s (NSHQ) është pika kryesore e zhvillimit, koordinimit dhe drejtimit për të gjitha aktivitetet e Operacioneve Speciale të NATO-s.

E vendosur në Shtabin Suprem të Fuqive Aleate në Europë (SHAPE) në Mons, Belgjikë dhe nën komandën e përditshme operacionale të drejtpërdrejtë të Komandantit Suprem të Aleatëve në Europë (SACEUR), NSHQ fokusohet në sigurimin e personelit që të ketë një bazë shumëkombëshe për t'i lejuar ata të veprojnë si në mënyrë efektive, efikase dhe koherente sa të jetë e mundur në mbështetje të objektivave të Aleancës nga niveli strategjik në atë taktik. Njëzet e gjashtë vende anëtare të NATO-s dhe tre partnerë (Austria, Finlanda dhe Suedia) përfaqësohen midis 200 forcash plus personelin e shtabit. NSHQ është një organizatë hibride unike. Ajo është e përfshirë në një grup shumë të larmishëm aktivitetesh si politika, doktrina, aftësitë, standardet, trajnimi dhe edukimi i SOFi NATO-s. Në baza ditore, NSHQ koordinon, avokon dhe këshillon në mënyrë aktive SOF referencën në të gjithë NATO-n. Këto aktivitete përfshijnë fusha të tilla si intelijenca specifike për SOF, aviacionin, mbështetja mjekësore dhe komunikimi.

NSHQ gjithashtu mbështet përfshirjen e SOF në operacionet e NATO-s. Kjo përfshin ndihmën me gjenerimin e forcave SOF, integrimin në planifikimin strategjik dhe operacionel dhe analizën e intelijençës specifike të SOF. Ekziston një element i Komandës së Komponentit të Operacioneve Speciale përgjegjës për komandimin dhe kontrollin e SOF brenda Forcës së Reagimit të NATO-s (NRF). Ky element ofrohet mbi baza rrotulluese nga një pjesë e vogël e vendeve që zotërojnë kapacitetin dhe aftësinë e nevojshme SOF. Përmirësimi i mekanizmave të komandës dhe kontrollit të SOF-it është gjithashtu një fushë ku NSHQ punon me zell për të integruar më mirë SOF-në në stërvitjet e NATO-s që nga fillimi dhe dizajnimi i tyre fillestar deri në mbledhjen e mësimeve të nxjerra.

NSHQ ofron një opsion shtesë komandimi dhe kontrolli të SOF të NATO-s për të plotësuar mekanizmat e tjerë ekzistues të ofruar nga vendet anëtare të NATO-s për NRF-në. Në Samitin e Uellsit në shtator 2014, aleatët deklaruan Komandën e Komponentit të Operacioneve Speciale të NSHQ-së, elementin bazë në aftësi të plotë operacionale. Kjo është një aftësi e shkallëzueshme e komandës dhe kontrollit të SOF të NATO-s nën komandën e përditshme të SACEUR, e cila është e shkathët, e përgjegjshme dhe e aftë për t'u vendosur për të mbështetur operacionet e NATO-s në një njoftim shumë të shkurtër. NSHQ

është gjithashtu një shtyllë e CFI, e cila synon të sigurojë që aleatët dhe partnerët të ruajnë përparimin e bërë në drejtim të ndërveprimit dhe bashkëpunimit nga përvoja e tyre duke punuar së bashku gjatë vendosjeve shumëkombëshe, si në Afganistan, Libi, Bririn e Afrikës dhe Ballkani.

NSHQ gjithashtu mbështet përfshirjen e SOF në operacionet e NATO-s. Kjo përfshin ndihmën me gjenerimin e forcave SOF, integrimin në planifikimin strategjik dhe operacionel dhe analizën e intelijençës specifike të SOF. Ekziston një element i Komandës së Komponentit të Operacioneve Speciale përgjegjës për komandimin dhe kontrollin e SOF brenda Forcës së Reagimit të NATO-s (NRF). Ky element ofrohet mbi baza rrotulluese nga një pjesë e vogël e vendeve që zotërojnë kapacitetin dhe aftësinë e nevojshme SOF. Përmirësimi i mekanizmave të komandës dhe kontrollit të SOF-it është gjithashtu një fushë ku NSHQ punon me zell për të integruar më mirë SOF-në në stërvitjet e NATO-s që nga fillimi dhe dizajnimi i tyre fillestar deri në mbledhjen e mësimeve të nxjerra. NSHQ luan një rol jetik në lidhjen e forcave, planifikimin dhe koordinimin e misioneve dhe përmirësimin e bashkëpunimit dhe lidhjes ndërmjet personelit të SOF të vendeve. Arsyja e ekzistencës së NSHQ-së është nevojja për të lidhur më mirë personelin SOF nga aleatët e NATO-s, në mënyrë që të mundësohet vendosja e tyre koherente në operacionet e NATO-s. Rrjeti SOF mbështetet nga një rrjet i sofistikuar teknologjik dhe mjete shoqëruese që mundësojnë bashkëpunim në kohë reale nga niveli strategjik në atë taktik. Këta përbërës kolektivisht lejojnë personelin e SOF të NATO-s të veprojnë me besim në mjedisin e sotëm kompleks dhe të pasigurt operacionel të sigurisë.

Trajnimi dhe edukimi nga ana tjetër është përpjekja kryesore në NSHQ sepse këto përpjekje krijojnë efektin afatgjatë të ndërtimit të një kuadri koherent për SOF të NATO-s. Trajnimi i NSHQ zhvillohet kryesisht në Shkollën SOF të NATO-s në bazën ajrore të Chièvres, ku studentët studiojnë një gamë të gjerë lëndësh, doktrinash të përbashkëta dhe procese aktuale të NATO-s. Këto mjete i mundësojnë personelit të NATO-s, SOF, nga shumë vende të bashkohen pa probleme në operacione dhe në ushtrime, duke përdorur metoda të përbashkëta. Ndërsa shumica e marrëdhënieve të SOF formohen në terren ose gjatë trajnimit, NSHQ përdor gjithashtu lidhje të avancuara komunikimi, si telekonferenca e sigurt me video për të plotësuar ndërveprimin ballë për ballë dhe për të bashkuar personelin nga të gjitha fushat e operacioneve për konferenca, seminare dhe shkëmbime pikëpamjesh në baza ditore.

Ndërsa origjina e NSHQ-së buron nga Iniciativa e Transformimit të NATO-s SOF e shpallur në Samitin e Rigës 2006, NSHQ ka qenë në skenë vetëm që nga marsi 2010. Në atë kohë të shkurtër, NSHQ dhe organizata e saj pararendëse, Qendra Koordinuese SOF e NATO-s, kanë bërë hapa të jashtëzakonshëm dhe të shpejtë për të nxjerrë në pah aftësitë e SOF në Aleancë.

Ti e di shumë mirë se femra është si diamanti, mos e lër vezullimin tënd të zbehet për shkak të dikujt. Është në dorën tënde të jesh orbita e gjithë botës. Për fatin e mirë apo të keq, këtë s' di ta them, por e bindur jam që gjithçka tek një femër është zemër, madje edhe KOKA.



Unë jam forca që lëviz botën

ANJEZA MUSOLLARI,
SHEFE E SEKTORIT TË BOTIMEVE

E dashur vetja ime!

Ti e di shumë mirë se femra është si diamanti, mos e lër vezullimin tënd të zbehet për shkak të dikujt. Është në dorën tënde të jesh orbita e gjithë botës.

Për fatin e mirë apo të keq, këtë s' di ta them, por e bindur jam që gjithçka tek një femër është zemër, madje edhe KOKA.

Mos nguro të luftosh për mua, për ty, për ne!

Ngrije zërin e ëmbël dhe ngjyrose fort me koloret e stinëve.

Askush më mirë se ti nuk e di vlerën tënde, demonstroje atë çdo ditë, sepse nëse nuk e bën ti, kush do e bëjë atëherë?!

Ti që në këtë botë ke lindur e vetme dhe po vetëm do ikësh!!

Ti e di shumë mirë se të marrësh një buzëqeshje nga ajo çka dhurove është shumë më e çmuar se sa të ta japin!

Beso në fuqinë e fjalës sepse ti e di që fjala është metamorfoza e gjithçkaje që ka një emër.

E dashur vetja ime, mbi të gjitha ti e di që një femër është e ndërvarur nga një mashkull, aq sa peshku nga një biçikletë!

SHIKOJE mashkullin e jetës tënde si një krah të djathtë dhe si një partner të devotshëm që do ndash momentet e hidhura dhe ato të bukura por jo, SI një SHPËTIM!

E dashur vetja ime kujto mbi të gjitha se ti je krijuar nga brinjët e mashkullit me qëllimin e vetëm, që mos të jesh as më poshtë e as më lartë se ai.

Të jesh femër do të thotë të ndryshojë humori disa herë në ditë.

Ndodh kjo, sepse ajo e ndjen çdo gjë madje edhe ajrin, gjithmonë ka një shkak për çdo gjendje emocionale të saj. Edhe nëse të thotë "s'kam gjë", gënjen. Pret që ta pyesësh përsëri që ajo të qajë në krahët e tu, nëse nuk janë ata që i kanë shkaktuar këto ujëvara?

Femër nuk është vetëm një lëkurë, është një botë brenda që pret ta zbulosh ti.

Sigurisht, jo nëse je aq i verbër sa ta shohësh nga jashtë.

Femër është t'i gjeshe defektet e tua e të gjeshe çdo lloj mënyre të mundshme për t'i fshehur.

Nuk mund t'i thuash kurrë një femre, që është "e shëmtuar", sepse nuk ka të tillë. Nëse nuk është piktura që ti doje, do të jetë dikush tjetër që e adhuron atë kreaturë.

Nuk mund ta ofendosh një femër. Një femër nuk bën si delikate, ajo është.

Femra që kur është fëmijë është një nënë, ndërsa mashkulli bëhet baba në momentin që merr fëmijën e tij në krahë.

Ndaj ajo është mësuar që njerëzit t'i trajtojë me dhembshurinë e nënës.

Nuk kam takuar asnjëherë një femër që nuk është e fortë, por ndonjëherë ato nuk dinë ta tregojnë forcën që kanë.

Por sa e lehtë është të jesh femër në një vend të ish-diktaturave komuniste?

Është lehtë ta ketë një opinion të vet të lirë, femra e një populli të lirë e të civilizuar, por është krenari që femra shqiptare mbijetoi aq fuqishëm me gjenin e saj trashëgues, në një popull të robëruar e të shtypur e të shkatërruar me themel, shkruar e hi nëpër mijëvjeçarët histerik!



Edhe sot, pas mijëra diskriminimeve deri në prag zhdukjeje ndaj kombit shqiptar, femra shqiptare mbetet Hyjnia e Botës, ku vetëm me pak kujdes e vetëpohim personaliteti, arrin të renditet edhe mbi femrat e popujve më të civilizuar.

Bukuria, Mençuria, Nderi, Besa Shqiptare, Zgjuarsia, Guximi në një jetë aq të vështirë. Guximi ndaj edhe gjakpirësve më të egjërë barbarë, Femra Shqiptare, kurrë nuk iu përkul me Nderin e saj - as pushtuesve, as mbretërve as shtat' krajlëve - por e ruajti gjenin e vet trashëgues edhe në momentet më kritike të jetës, duke sakrifikuar edhe vet Jetën para pushtuesve, çnderuesve, dhe krijoi histori unike, mbase të pa konceptueshme për një botë që parimet shqiptare i ka utopi!...

Dihet se çdo kohë ka ngritjet e rëniet e veta, shkundjet e jetës, e nuk ka se si të mos bjerë gjethe e ndonjë dege Lisash, por kurrë lisa të rrëzuar përdhe! Ndikimet e huaja e qëllimkëqija, mund të vyshkin edhe lule shumë të bukura erëkëndshme, po kopshti shqiptar është i ruajtur nga Gjenerali Trashëgues, sado rënie e sakrificë të ketë! Paramendonit: cila femër vetëflijohet, para një çnderimit të huaj?

Po cila femër nuk e lë embrionin e huaj as të lindet gjallë?

Femra shqiptare është Hyjnia illiro-pellgazgjike, është po ajo hyjnia antike, po ato perëndeshat olimpikë, po ata "pellgazgët Hyjnorë", që ndërtauan nga Akropoli, Aleksandria, e Hindi, e gati të gjitha mrekullitë e botës!

Femra shqiptare sot, e ka në vetëdijen e saj aftësinë e mbijetesës kudo ndodhet dhe opinionin e saj është i lirë dhe i hapur fëmijë, vajzë, nuse, grua a e moshuar ajo do t'i hapet udha e opinionit, se e

ka trashëgim nderin e themelit të personalitetit.

Fuqizimi i grave është një nga gjërat më të drejta që duhet bërë thjesht për arsyen morale, sepse gjysma e botës përballlet me diskriminimin në bazë të gjinisë së tyre dhe kjo situatë mund të ndryshohet.

Gratë në Shqipëri kanë të drejtë të jenë të sigurt në shtëpitë e tyre dhe në komunitet, të jenë të arsimuara, të kenë kontroll mbi trupat e tyre dhe jetën e tyre.

Tradita shqiptare e ka luftuar gjithmonë me definitivitetet e roleve gjinore dhe përgjegjësitë, pozitën e gruas në shoqëri. Megjithatë është e qartë në opinion publik, që angazhimin e femrës e shohin si themelor për të mbështetur dinjitetin njerëzor dhe për respektimin e sfidave unike që gratë përballen. Fuqizimi i grave, gjithashtu ka aftësinë për të krijuar efekte të panumërta të tjera: për të krijuar një botë më të shëndetshme, me më shumë të arsimuar, dhe me më pak të varfër. Fuqizimi i grave të arsimuara p.sh. bën të mundur që ato të mund të ushtrojnë pushtetin, në një lloj forme, në familjet e tyre dhe komunitetet, për të ndërtuar në shoqërinë civile në luftë kundër varfërisë dhe për të punuar për një botë që është për të gjithë.

Grua, ti ke forcë dhe ti e di këtë, por e di në mënyrën e gabuar, e nëse ende nuk e ke të qartë, kthehu dhe kontrolloje veten, pendohu që më vonë të mos thuash: "Mos më shkel në kujtime, të lutem, kam dhimbje", por të kaluarën tënde t'ua rrëfesh mbesave e nipërve si një përrallë të këndshme, me personazh kryesor një grua, që ka përdorur fuqinë e saj në mënyrën e duhur, rrëfeu atyre që personazhi kryesor i kësaj përralle je ti,

je ti e cila ke kaluar jetën tënde si mbretëreshë, duke edukuar fëmijët e tu.

A nuk do jetë për ta më e këndshme të dëgjonin këtë, në vend se të dëgjojnë jetën e gjyshes së tyre si një aventurë e dhimbshme me përfundim të dhimbshëm, e pse? ...sepse ke dashur që të shijojnë të mirat mashtruese të këtij udhëtimit.

Dogmat dhe paragjykimet e kulturës shqiptare

Nderi i femrave të familjes është pika delikate e krenarisë të meshkujve shqiptarë, në shoqërinë tonë ka edhe shumë keqkuptime dogmatike të cilat rrisin diskriminimin gjinor.

Arsimi jo i mjaftueshëm i femrave apo ambicijet e ulëta të tyre bëjnë që ato të mbeten ekonomikisht të varura prej burrave.

Përmes kulturës, vetëdijes, pabarazisë gjinore të një populli mund të kuptojmë se emancipimi i saj është i domosdoshëm në të mirën e saj dhe gjithë shoqërisë.

Nëse emancipimi i saj nuk arrin në shkallën e duhur, nuk ke mundur të ndërtohet atë popull ne skemën e duhur të një populli të zhvilluar.

Zhvillimi dhe emancipimi i gruas në shoqërinë e sotme moderne i jep një imazh i shtetit se në cilën shkallë të kulturës je si popull apo komb.

E dashur vetja ime, më ilumino rrugën e forcës që çdo femër të gjejë tek unë, tek njëra - tjetra atë që gjatë udhëtimit të jetës vargonjtë e sfidave ia kanë marrë përdhunshëm...

"Një grua është si një bustinë çaji, ti asnjëherë nuk e di sa e fortë është ajo deri sa e vendos në ujë të nxehtë".



NGA SALI ONUZI*

KOLONEL HALIL KATANA, ushtaraku, gazetari dhe qytetari me gjurmë të arta në panteonin e vlerave të FA-së

Halil Katana ka lindur më 15 dhjetor 1939, në fshatin Degë të Tropojës, në një familje me tradita të shquara atdhetare, me emër në Malësinë e Gjakovës. Stërgjyshi i Halilit, në vitin 1852, kish rënë në luftë për mbrojtjen e trojeve amtare nga ushtria pushtuese malazeze. Gjyshi, Avdyli, kish marrë pjesë në Kuvendin e Junikut dhe ishte bashkuar me forcat kryengritëse të vitit 1910, të komanduara nga Isa Boletini. Babai i Halilit, Mehmeti, më 1912, në krye të burrave të fshatit Degë, kish luftuar në Qafën e Prushit, nën komandën e Bajram Currit.

Familja e Mehmet Katanës dhe vëllezërit e tij e kishin përkrahur Lëvizjen dhe Luftën ANÇ. Hysen Katana, mixha i Halilit, do të rreshtohet partizan në Brigadën e 25 shtatorit dhe do të luftonte në radhët e saj për çlirimin e Kosovës.

Halil Katana, 5 vjeç, mbeti pa nënë Fatimen në dimrin e vitit 1944, në kohën e operacionit gjermano-ballist, të cilët kishin shkuar në Degë për të ndëshkuar banorët e saj pse kishin mbajtur partizanët. Me 1945 do të ndahej nga jeta dhe babai i Halilit, Mehmet Katana. Për Halilin dhe vëllanë e tij më të vogël, u kujdes gjyshja e tyre nga babai, Ajne Sylja, deri në vitin 1947, kur dhe ajo u nda nga jeta. Pas kësaj kohe, nëna e tyre u bë Shkurtë Ademja, gruaja e mixhës së tyre, Haxhiut, që nuk i ndau nga fëmijët e saj. Halili i ka kushtuar një libër të vogël asaj, të shkruar me dashuri të madhe me ngrohtësi e bukuri. Halili është kujdesur për Shkurtën si për nënën e tij, ndonëse ajo kishte katër djem e dy vajza. Disa vite më vonë, më 1956, vdiq edhe vëllai i vetëm më i vogël i Halilit, Avdyli, në moshën 12 vjeçare, nga shpërthimi i një granate të luftës dytë botërore.

Halili e kaloi fëmijërinë në vendlindje, ku kreu shkollën fillore. Shkollën 7-vjeçare e mbaroi në qytetin "Bajram Curri", konviktor me bursë shteti. Mësonte shumë dhe mbaroi shkollën shkëlqyer. Pas kësaj kohe ai do të merrte pjesë në disa aksione vullnetare në moshën 13-vjeçare, më 1952, në hapjen e rrugës së Dritës për hidrocentralin e Matit, në vitin 1955 në kantierin e hidrocentralit të Ulzës, në aksionin e rrugës Shëmbri-Kolqecaj dhe më vonë, si oficer me rininë e ushtrisë, në vitet 1960 në Rugën e Malësisë së Madhe e më pas në Hekurudhën Elbasan - Përrerjas, në rrugën e Komani etj.

Pas mbarimit të 7-vjeçares fitoi të drejtën të vijonte mësimet në shkollën ushtarake "Skënderbej" në kryeqytet. Ky ishte një fat i madh për malësorin e ri, ku do të dallohej përsëri. Më 1958 vijon studimet në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve në Tiranë në specialitetin e ndërlidhjes. Për rezultate të larta në mësimet e stërvitje caktohet zëvendëskomandant toge me gradë kapter. Pas mbarimit të Shkollës së Oficerëve me rezultate të shkëlqyera, gradohet toger, siç ishin raste të veçanta.

Oficer i ri, emërohet komandant toge në batalionin e Ndërlidhjes të Brigadës së Shkodrës. Por pas një muaji rikthehet, po komandant toge, në Shkollën e Bashkuar në Tiranë ku dallohet për disiplinë dhe aftësi komanduese. Mehmet Katana, i biri, inxhinier, e kujton mirë çfarë i ka thënë i ati, Halili. Kur u prishën marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik dhe de fakto edhe me Traktatin e Varshavës, Halilin e thërrasin me urdhër të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, për të vënë në punë Radiostacionin e ndërlidhjes që përdornin ushtarakët sovjetikë për ndërlidhje me Traktatin e Varshavës. Ky stacion ndodhej në Petrelë. Detyra ishte që ky stacion të kthehej për ndërlidhje e komunikim për Ushtrinë tonë. Oficeri i ri Halil Katana, ia doli me sukses detyrës së tij. Petrit Dume me këtë rast mburrej me të. Po edhe Halil Katana e kujtonte vazhdimisht gjeneralin, Heroin e Popullit. Madje Halili ishte edhe redaktori i librit për Petrit Dumen, shkruar nga Rustem Haxhia.

Me punë e dije, Halil Katana do të ngjitet shpejt në shkallët e karrierës, komandant kompanie, komandant i batalionit autonom të Qendrës së Ndërlidhjes së Ministrisë së Mbrojtjes. Puna e lidhi me Tiranën dhe do të jetë kryeqyteti ku do të njihet e martohet me shoqen e tij tiranase, Bedrien, me të cilën kaluan bashkë një jetë të mrekullueshme familjare.

Në vitet 1964-1967 vazhdon studimet në Akademinë Ushtarake, të cilën e mbaron me diplomë "Shkëqyer", të serisë së veçantë. Një fazë e re do të nisë për Halil Katanën, kur ai emërohet pedagog i specialitetit të Ndërlidhjes në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve. I përgatitur me dijet e Shkollave që kish mbaruar dhe i ngritur profesionalisht në detyrat që kish kryer, Halil Katana do të dallohet edhe në detyrën e pedagogu, duke studiuar dhe punuar me pasion e përkushtim. Në këtë kohë Halil Katana përgatit e boton 4 libra



për Radioteknikën; ky ishte sinjali se ai tanimë po bëhej një oficer me përvojë që studioje dhe përfitonte nga praktika e stërvitjet ushtarake për t'i kthyer këto në tekste mësimore e shkencore.

Në vitin 1981 Katana kalon në shtypin ushtarak si redaktor i Revistës "Për mbrojtjen e Atdheut", më pas "Mbrojtja". Në vitin 1992, me të ashtuquajturën reformë në nxor edhe ai në lirim të parakohshëm, pa asnjë argument, vetëm për bindjet e tij personale. Halil Katana do të fillonte menjëherë nga veprimtaria shoqërore. Bashkë me shkrimtarin e mirënjohur Resul Bedo krijuan Shoqatën "Për të rënë e kombit shqiptar" me organin e tyre "Për Mëmëdhenë". Por më 1996 kjo shoqatë u bashkua me atë të familjeve të Dëshmorëve të Luftës NÇ dhe krijuan Organizatën "Për dëshmorët e luftës ANÇ dhe dëshmorët e tjerë të Atdheut". Katana do të zgjidhej në kryesinë e Këshillit kombëtar të saj dhe do të ishte kryeredaktor i Revistës "Pavdekësia". Më 1997 Katana do të merrte gradën e "Kolonelit" dhe do të rikthehej në Ushtri në Revistën "Mbrojtja" si kryeredaktor i saj. Por, kur në vitin 2000 doli në pension, u rikthye të Organizata kombëtare për Dëshmorët e Atdheut, ku punoi deri sa qe gjallë. Në këtë detyrë Halili e shtoi edhe më shumë numrin e veprimtarëve e të bashkëpunorëve. Miqtë e tij të shumtë e prisnin më kënaqësi në të gjitha anët e Shqipërisë, po edhe në Kosovë, sidomos te Radio "Kosova e Lirë", me të cilën kish bashkëpunuar edhe gjatë luftës së UÇK-së.

Halil Katana ishte një rast i rrallë, në mos i vetëm që kish mbaruar Akademinë ushtarake e punonte në shtypin qendror ushtarak. Përgjithësisht dhe natyrisht, kjo kategori i hynin rrugës së karrierës ushtarake nga Brigada në Korpus (divizion) e Shtab të Përgjithshëm. Dhe ishte normale. Halil Katana kish mbaruar shkëlqyer Akademinë ushtarake, por i hyri shtypit. A nuk kishte mbaruar ai shkëlqyer për Ndërlidhje? Kish qenë edhe komandant i batalionit, edhe pedagog i këtij specialiteti në Shkollën e Bashkuar. Ai mund të bënte karrierë si rrallë kush deri në Shtabin e Përgjithshëm. Po atij, që e dashuronit këtë shërbim të mrekullueshëm, që jep e merr informacionin, i qante shpirti për një lloj shërbimi dhe informacioni tjetër, për shtypin, për median e shkruar. Me siguri ai kish shumë përjetime dhe emocione nga jeta në ushtri e para saj dhe donte t'i bënte të njohura ato. Shtypi i jepte mundësi të trajtonte luftërat për liri, pavarësi e çlirim, trimëritë e burrave e të grave të Shqipërisë. Kjo e sundonte shpirtin e tij dhe këtu u vendos deri në fund, duke e ndarë jetën e punën e tij në dy pjesë gati të barabarta, 20 vjet në reparte, Shkollë e Akademi dhe 20 vjet në shtypin ushtarak. Sikur i kish ndarë me dorë! Dhe duhet shënuar se shtypi ushtarak ka përfutur nga ky ushtarak dhe gazetari i talentuar. Ai ishte i pakonkurrueshëm në njohjen e jetës ushtarake, të ushtarit e të oficerit, të komandantit e të komisarit, të shefit të shërbimit e të komandantit të armës. Prandaj Halil Katana i rrinte shumë afër repartit dhe jetës ushtarake, pasi kishte kodin e njohjes e të zbrërthimit të saj. Po ai nuk u shkëput as nga studimet universitare, do të bënte dy vjet kurs pasuniversitar në gazetari në Universitetin e Tiranës, në fakultetin e Histori-filogjisë; dhe më pas, edhe kursin njëvjeçar të Filozofisë.

Kishte në shtypin ushtarak djem e vajza gazetare, që kishin ardhur nga universiteti, nga



Të gjithë në rolin e tyre, disa kanë shkëlqyer, por nëse kanë zotëruar mendim, teknikë të shkruarit e bukuri fraze, Halil Katanën në veçanti e tërhiqte jeta, e vërteta dhe guximi për ta shpallë atë hapur për të gjithë. Besoj se nuk ka pasur që t'ia kenë dalë ta ndalojnë, t'i mbyllin gojën e thajne dorën. Prandaj, herë pas here ai e kujtonte me dashuri e mall Ndërlidhjen, jetën e oficerit dhe të pedagogu, veprat që kish shkruar për Radioteknikën. Po edhe ndërlidhja e ndihmoi edhe më tej kolonel Katanën. Në fillim të viteve 2000, ai ishte pajisur me një Laptop shumë të mirë që ia kishte dhuruar i biri, në Itali. Halili ishte një njohës i hollë e entuziast i teknologjisë së informacionit dhe një përdorues mjeshtrë i saj. Laptopin nuk e hiqte nga krahu. Pasi mbeshej me informacione, atë e gjeje në Bibliotekën Kombëtare, duke hedhur shkrimet për revistën e tij të dashur "Pavdekësia".

Informacionin: ku se kërkonte atë. Aty ku s'ta merrte mendja. Ai ishte një reporter model, për të mbledhur e grumbulluar informacion nga terreni, nga repartet, nga shkollat e shumta ushtarake, etj. Ai solli me plot guxim në Revistën "Mbrojtja" edhe një rubrikë të shkëlqyer për oficerët, nënoficerët dhe ushtarët që mbrojtjen repartet më 1997, disa prej të cilëve kishin rënë në krye të detyrës. Duket e lehtë sot. Po atëherë opinioni ishte kthyer kundër ushtrisë, që kish lënë veten në dorë të anarkistëve e vandalëve, që e shkatërruan bazën e saj materiale dhe organizimin. Sapo filloi kjo rubrikë me heronjin e dëshmorët e saj, u fut në ushtri edhe një korrent frymëzues, pikërisht ajo që i duhej asaj për të vlerësuar trimat e dëshmorët, po dhe për të ngritur e ringritur ushtrinë tonë, në një kohë rekord, kur drejt trojeve shqiptare po afrohehin retë e zeza të luftës shoviniste të serbomëdhenjeve.

Kolonel Katana nuk e kish mbajtur për gjerdan kulturën ushtarake. Ai ishte një intelektual i vërtetë. Ai ishte mjeshtrë i organizimit të bisedave rreth tavolinës në redaksi, ose të intervistave. Ai gjithnjë kërkonte të ishte në korrekt të zhvillimeve, të kishte një njohje sa më të thellë të problemeve dhe të kuadrove që duheshin intervistuar apo thirrur në takim. U jepte kohë, u dërgonte pyetjet dhe i dëgjonte me shumë vëmendje. Ja çfarë ka shkruar vetë për këtë aspekt të punës së tij: "Si kryeredaktor i revistës "Mbrojtja" kisha vendosur t'i tërheq në këtë revistë drejtuesit kryesorë të shtetit dhe të Ushtrisë, nëpërmjet intervistave të gjera problemore, ku ata kishin mundësi të shpalosnin idetë e tyre për ringritjen (e Ushtrisë). Prandaj punoja shumë për hartimin e pyetjeve që do t'u jepja, në mënyrë që t'i orientoja me thelbin e problemeve që duheshin trajtuar prej tyre, në përshatje me funksionet që kishte secili. Ai mbante në fokusin e tij sidomos veteranët, me të cilët kishte marrëdhënie të ngrohta. Shumë prej tyre i njihje nga afër. Nxitonte që të vilte prej tyre sa më shumë. Ka mbetur si legjendë artikulli i gjeneralmajorit në pension, Qazim Kapisyzit, për datën e Çlirimit, 29 nëntorin, të cilin po e shkruante për revistën. Ai nuk kish vënë pikën e fundit, kish ndërruar jetë! Ata ishin heronj, që nuk përtornin e nuk kursenin as nga jeta e tyre për jetën dhe historinë e Ushtrisë, kur media i kërkonte, i afronte e u jepte mundësi të shkruanin. Halil Katana ishte një shembull në këtë drejtim për kolegët e tij gazetarë.

Halil Katana ishte një drejtues e krijues në shtypin ushtarak. Ai nuk mbyllej në korniza. Ajo që duhej komunikuar sot, ai bënte çmos ta

bënte të njohur në kohë. Edhe kur kish ndodhur ndonjëherë, që numri i radhës i revistës "Mbrojtja" kish dalë nga botimi, Halili me shokët e tij gazetarë, nuk prisnin edhe një muaj, përgatisnin dhe çonin në botim një "suplement", me pak faqe për temën aktuale dhe e shpërndanin bashkë me Revistën. E rregullonte këtë punë me drejtorët dhe shefat e financës, dhe me të tjerë. Punëtor i madh, i papajtueshëm me shkrimet e varfra. Mik i vërtetë i autorëve të rinj, me të cilët mbante lidhje dhe shkëmbente përvojë. Kur vinte re raste të plagjiaturës në ndonjë studim akademik, nuk përtonte t'ia thoshte në sy "autorit" të vërtetat një për një dhe ta kritikonte rreptë. Për të botuar as bëhej fjalë.

Kolonel Katana përdorte metoda pune të shkathëta, si ish njëra sot, nuk ish tjetra nesër, në përputhje me objektin e shkrimit. Kushdo mund ta lexojë në revistën "Pavdekësia", se si me të marrë vesh se këtu apo aty, u kishin hequr shkollave emrat e heronjve dhe dëshmorëve, Halili do gjendej atje, siguronte një njohje të plotë, kërkonte dhe realizonte një intervistë më kryetarin e Bashkisë së asaj kohe, të cilën bashkë dhe problemin ua vinte përpara disa personaliteteve shoqërore të njohur e të respektuar, të cilët me reagimet e tyre ndikonin për mirë në opinionin shoqëror.

Kolonel Katana kishte marrëdhënie shembullore me kolegët e vartësit e tij, gazetarë ose punonjës. Fjalëmbël, vlerësues i drejtë i punës së mirë, mbrojtës i hapur i së vërtetës, dashamirës, bashkë-bisedues i këndshëm, që s'lodhej së dëgjuari. Njeri më nivel të lartë kulturor, qytetar model në lagjen ku banonte, ku ish zgjedhur në detyra të rëndësishme shoqërore, të cilave nuk u bënte "bisht" si disa punonjës të lartë të administratës shtetërore e partiake. Ai ishte kolonel i ushtrisë, por mbi të gjitha ishte një shqiptar atdhetar, njeri dhe qytetar i dënjë i vendit të vet, që e donte aq shumë.

Halil Katana është autor i 13 librave, bashkautor në tri dhe ka redaktuar 12 libra të autorëve të tjerë... Pas katër librave për radioteknikën, Katana shkroi e botoi: "Isa Boletini - strateg i luftërave kryengritëse", "Për ata që u kthyen nga lufta fitimtarë", "Në ditët e pranverës së madhe", "Stërvitja e paqes", "Flamuri - kryesimbol i kombit", "Kudusi Lame - gjeneral i luftës". Ai është autor i qindra artikujve studimorë dhe publicistikë në fushën e historisë, të traditave tona kombëtare, sidomos për dëshmorët e heronjtë etj. Halili kishte plane për botime në të ardhmen.

Të gjithë, libra e artikuj, janë shkruar nga një dorë mjeshtri, por janë tre prej tyre, që sipas meje, veçojnë: "Ringritja e Ushtrisë Shqiptare '97-2000", "Tri dimensionet e Luftës Çlirimtare të Kosovës" dhe "Vlaga e kësaj toke".

Në parathënien e librit: "Ringritja e Ushtrisë Shqiptare", gjeneralmajor, prof. dr. Kostaq Karoli shkruan: "Ringritjen e ushtrisë e ka sjellë natyrisht si një proces organik i ringritjes së shtetit shqiptar dhe mbarë shoqërisë shqiptare, pas krizës së thellë që kishte pësuar... Autori ka meritën që me guxim dhe kurajë hedh dritë mbi ato ngjarje tronditëse dhe, në një plan tjetër tregon punën kolosale të oficerëve për përballimin e kësaj sfide... Ndër këta oficerë, ndofta më i vjetri, bën pjesë edhe vetë autori me një shpirt të paepur atdhetar dhe me përkushtim të rrallë, e ndoqi hap pas hapi tërë procesin e ringritjes, duke qenë i pranishëm në çdo veprimtari kryesore e në çdo njësi të Ushtrisë që nga Saranda në Tropojë... Lexuesi në këtë libër do të njohë me emër e mbiemër me qindra oficerë, nënoficerë, ushtarë dhe punonjës që dhanë gjakun, djersën, shpirtin dhe dituritë e tyre për ringritjen e shpejtë të Ushtrisë." Ringritja e ushtrisë shqiptare ishte një domosdoshmëri urgjente edhe për shkak të ngjarjeve që po i kërcënoheshin Kosovës. Këtë kohë Halili e ka ndjekur me shumë interesim. Më 1998-1999, Halil Katana do të ndodhej rregullisht në Lumë, Has e Tropojë për të ndjekur nga afër ngjarjet. Por mund ta shihje që linte zyrën dhe, në pritje të lajmeve nga Kosova, i shqetësuar bënte ndonjë xhiro në sheshin e Ministrisë së Mbrojtjes, sepse shiç thuhet "nuk i zinte vendi vend", duke pritur ndonjë situatë të re nga telefoni satelitor i kuadrove të UÇK-së e burime të tjera. Kështu shkroi shumë artikuj shkruar kësaj teme. Madje ai ishte i pari që u fut në Kosovë për të takuar, menjëherë pas mbarimit të Luftës, drejtuesit dhe anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm

të UÇK-së e për të biseduar me to, për të marrë intervista etj. Kishte shkuar për të parë nga afër edhe pozicione të luftës.

Pas fitores kolonel Katana do të botonte në vitin 2002 librin "Tri dimensionet e Luftës Çlirimtare të Kosovës", në parathënien e së cilës ministri i Mbrojtjes (1997-1998) prof. dr. Sabit Brokaj shkruan se Halil Katana ka qenë, në thelb, pjesëmarrës aktiv i kësaj veprimtarie patriotike, politike, organizuese e drejtuese ushtarake. Ai ka qenë në lidhje të ngushtë me ideatorët dhe organizatorët që në fillimet e viteve '90, ka qenë në kontakt me shumicën e drejtuesve të saj gjatë gjithë kësaj lufte, duke përjetuar të gjitha fazat e saj, nëpërmjet informacionesh, këshillash dhe porosish të karakterit politik e ushtarak. Fati e solli që gjatë luftës të jetë kryeredaktor i revistës "Mbrojtja", të cilën e orientoi në dobi të Luftës Çlirimtare të Kosovës, si të ishte organ i saj". Sabit Brokaj me të drejtë shkruante se "libri i Halil Katanës për UÇK-në do të ishte në krye të të gjithë librave që do të botoheshin, sepse është shkruar nga një njohës i shkëlqyer i Historisë sonë kombëtare, nga një patriot, ku dashuria për Kosovën dhe historinë e saj është në majë të penës së tij. Është shkruar nga një ushtarak kompetent dhe publicist e shkrimtar, ku do rresht i shkruar prej tij të jep kënaqësi intelektuale, që provohet jo aq shpesh gjatë leximit të botimet e sotme".

Vepra tjetër, është "Vlaga e kësaj toke", titull që e zgjodhi për të njeriu i madh i kulturës shqiptare, Dritëro Agolli, ish-veteran i Luftës ANÇ. Ky libër është fryt i punës së dy kohëve, vitet 1992-1997, kur Halil Katana ishte shkëputur padrejtësisht, e përkohësisht, fizikisht nga Ushtria dhe e dyta e viteve 2000-2009, kur ai doli në pension pleqërie dhe punoi si kryeredaktor i revistës "Pavdekësia". Në asnjë libër tjetër nuk janë përmbledhur aq bukur punët e mëdha që u bënë në këto vite për themelimin e Organizatës kombëtare për dëshmorët e LANÇ dhe dëshmorët e tjerë të Atdheut, dhe të punës së saj heroike për të përkujtuar dhe ngritur lart Dëshmorët e Atdheut, emrin dhe veprën e të cilëve në këtë kohë guxuan ta marrin nëpër këmbë grupe të caktuara, parti politike e deri qeveri të kohës. Në këtë kohë ndodhnin absurditete e veprime antihistorike. Nëpër bashki e komuna kishte filluar në masë heqja e emrave të heronjve dhe të dëshmorëve nga Shkollat po dhe nga rrugët e sheshet!!! Është kjo kohë kur, me iniciativën e vet, Organizata e familjeve të Dëshmorëve të LANÇ-it filloi nga puna me konsultime të gjera me anëtarësinë e saj për hartimin e projekteve të saj për Statusin e Dëshmorit të Atdheut, që përfundoi në prill të vitit 2000, me miratimin ligjor nga Kuvendi i Republikës me unanimitet të plotë. Libri është një dëshmi e punës së madhe të vetë autorit në mbrojtje të veprës së Dëshmorëve të Atdheut dhe të vlerësimit e përkujtimit të tyre.

Halil Katana u nda nga jeta pas një sëmundjeje të shkurtër e të rëndë, më 16 qershor 2012, ende pa mbushur as 73 vjeç, një dekadë më parë, duke lënë pas të shoqen Bedrien, dy djemtë e tij Ardianin e Mehmetin dhe botimet e tij të shumta, me të cilat ai së një vend nimeri në publicistikën ushtarake dhe atë shqiptare. Halil Katana është dekoruar me disa tituj dhe medalje. Këshilli i Bashkisë së Bajram Currit e ka shpallur atë "Qytetar Nderi" (pas vdekjes), me motivacion "Drejtues dhe pedagog i fushës ushtarake, publicist dhe shkrimtar që gjithë jetën ia përkushtoi Atdheut dhe vlerave të Kombit". Bashkia e qytetit të Gjirokastrës e ka nderuar, më 12 korrik 2012, me titullin "Mirënjohja e qytetit" me motivacion: "Publicist simpatizant, admires e pasqyruar dinjitoz i patriotizmit të qytetit të Gjirokastrës". Halil Katana është shpallur "Anëtar nderi i Organizatës për dëshmorët e Luftës ANÇ dhe dëshmorët e tjerë të Atdheut". Vepra e tij e plotë pret të studiohet dhe të çmohet siç e meriton. Me këtë rast falënderoj për bashkëpunimin familjen, të birin Mehmetin, nipin e Halilit, Danjelin dhe nënën e tij prof. Ajshen. Po edhe kryeredaktorin gazetës "Ushtria", zonjën Anjeza Musollari, e cila ma besoi mua këtë artikull përkujtimor për mikun tim të paharruar Halil Katanën.

*Kolonel në pension, anëtar i Shtabit të Përgjithshëm, drejtor i Edukimit dhe Kulturës së Ushtrisë më 1991-1992 dhe i Departamentit të Veteranëve të Luftës, 1995-2001.



Kurseni gazin për një dimër të sigurt!

Shtetet anëtare angazhohen për të reduktuar kërkesën për gaz me 15% dimrin e ardhshëm

Bashkimi European përballet me rrezikun e ndërprerjeve të mëtejshme të furnizimit me gaz nga Rusia, me pothuajse gjysmën e shteteve anëtare tashmë të prekura nga furnizimet e reduktuara. Marrja e masave tani mund të zvogëlojë rrezikun dhe kostot për Europën në rast të përçarjes së mëtejshme ose të plotë, duke forcuar elasticitetin evropian të energjisë.

Në përpjekje për të rritur sigurinë e furnizimit me energji të BE-së, vendet anëtare arritën një marrëveshje politike për një reduktim vullnetar të kërkesës për gaz natyror me 15% këtë dimër. Rregullorja e Këshillit gjithashtu parashikon mundësinë e aktivizimit të një "Alarmi të Unionit" për sigurinë e furnizimit, rast në të cilin reduktimi i kërkesës për gaz do të bëhet i detyrueshëm.

Qëllimi i reduktimit të kërkesës për gaz është të bëhen kurse përpara dimrit në mënyrë që të përgatiten për ndërprerje të mundshme të furnizimit me gaz nga Rusia, e cila vazhdimisht përdor furnizimin me energji si armë.


"BE-ja është e bashkuar dhe solidare. Vendimi i sotëm ka treguar qartë se vendet anëtare do të qëndrojnë kundër çdo përpjekjeje ruse për të përçarë BE-në duke përdorur furnizimet me energji si armë. Miratimi i propozimit për reduktimin e gazit në kohë rekord ka forcuar padyshim sigurinë tonë të përbashkët të energjisë. Kursimi i gazit tani do të përmirësojë gatishmërinë. Dimri do të jetë shumë më i lirë dhe më i lehtë për qytetarët dhe industrinë e BE-së", - deklaroi Jozef Síkela, ministër çek i Industrisë dhe Tregtisë

Shtetet anëtare ranë dakord të reduktojnë kërkesën e tyre për gaz me 15% krahasuar me konsumin mesatar të tyre në pesë vitet e fundit, midis 1 gushtit 2022 dhe 31 marsit 2023, me masa të zgjedhjes së tyre.

Ndërsa të gjitha vendet e BE-së do të bëjnë përpjekjet e tyre më të mira për të përmbushur reduktimet, Këshilli specifikoi disa përjashtime dhe mundësi për të kërkuar një shmangie nga objektivi i reduktimit të detyrueshëm, në mënyrë që të pasqyrohen situatat e veçanta të shteteve anëtare dhe të sigurohet që reduktimet e gazit të jenë efektive në rritjen e sigurisë së furnizimit në BE.

Këshilli ra dakord që shtetet anëtare që nuk janë të ndërlidhura me rrjetet e gazit të shteteve të tjera anëtare përjashtohen nga reduktimet e detyrueshme të gazit pasi nuk do të jenë në gjendje të çlirojnë vëllime të konsiderueshme të gazit të tubacionit në dobi të shteteve të tjera anëtare. Përjashtohen gjithashtu shtetet anëtare, rrjetet e energjisë elektrike të cilëve nuk janë të sinkronizuar me sistemin evropian të energjisë elektrike dhe varen shumë nga gaz për prodhimin e energjisë elektrike, për të shmangur rrezikun e një krize të furnizimit me energji elektrike.

Shtetet anëtare mund të kërkojnë një derogim për të përshtatur detyrimet e tyre për reduktimin e kërkesës nëse kanë interkoneksione të kufizuara me shtetet e tjera anëtare dhe



mund të tregojnë se kapacitetet e tyre të eksportit të interkonjeksionit ose infrastruktura e tyre vendase LNG përdoren për të ridrejtuar gazin në shtetet e tjera anëtare në maksimum.

Shtetet anëtare mund të kërkojnë gjithashtu një derogim nëse kanë tejkaluar objektivat e tyre të mbushjes së ruajtjes së gazit, nëse varen shumë

nga gazit si lëndë ushqyese për industrinë kritike ose nëse konsumi i tyre i gazit është rritur me të paktën 8% në vitin e kaluar krahasuar me mesataren të pesë viteve të fundit.

Shtetet anëtare ranë dakord të rrisin rolin e Këshillit në nxitjen e një "Alarmi të Bashkimit". Alarmi do të aktivizohet me një vendim

zbatues të Këshillit, duke vepruar sipas një propozimi nga Komisioni. Komisioni do të paraqesë një propozim për të aktivizuar një "Alarm të Bashkimit" në rast të një rreziku të konsiderueshëm të mungesës së rëndë të gazit ose një kërkesë jashtëzakonisht të lartë për gaz, ose nëse pesë ose më shumë shtete anëtare që kanë deklaruar një alarm në nivel kombëtar i kërkojnë Komisionit të bëjë kështu.

Kur zgjidhen masat e reduktimit të kërkesës, shtetet anëtare ranë dakord se duhet t'u japin përparësi masave që nuk prekin klientët e mbrojtur si familjet dhe shërbimet thelbësore për funksionimin e shoqërisë si subjektet kritike, kujdesi shëndetësor dhe mbrojtja. Masat e mundshme përfshijnë reduktimin e gazit të konsumuar në sektorin e energjisë elektrike, masat për inkurajimin e ndërrimit të karburantit në industri, fushatat kombëtare për rritjen e ndërgjegjësimit, detyrimet e synuara për të reduktuar ngrohjen dhe ftohjen dhe masat e bazuara në treg si ankandi ndërmjet kompanive.

Shtetet anëtare do të përditësojnë planet e tyre kombëtare të emergjencës që përcaktojnë masat për reduktimin e kërkesës që po planifikojnë dhe do t'i raportojnë rregullisht Komisionit për avancimin e planeve të tyre.

Rregullorja është një masë e jashtëzakonshme, e parashikuar për një kohë të kufizuar. Prandaj do të

aplikohet për një vit dhe Komisioni do të kryejë një rishikim për të shqyrtuar zgjatjen e tij në dritën e situatës së përgjithshme të furnizimit me gaz të BE-së, deri në maj 2023.

- BE-ja po përballet me një krizë potenciale të sigurisë së furnizimit me reduktim të ndjeshëm të dërgesave të gazit nga Rusia dhe një rrezik serioz të një ndalimi të plotë, për të cilin vendet anëtare duhet të përgatiten menjëherë në një mënyrë të koordinuar dhe një frymë solidariteti. Megjithatë të gjitha shtetet anëtare nuk po përballet aktualisht me një rrezik të konsiderueshëm të sigurisë së furnizimit, ndërprerjet e rënda në disa shtete anëtare do të ndikojnë në ekonominë e BE-së në tërësi.

Ai plotëson iniciativat dhe legjislacionin ekzistues të BE-së, të cilat sigurojnë që qytetarët të mund të përfitojnë nga furnizimet e sigurta me gaz dhe që klientët të mbrohen nga ndërprerjet e mëdha të furnizimit, veçanërisht Rregullorja (BE) 2017/1938 për sigurinë e furnizimit me gaz.

Kjo rregullore ndjek nisma të tjera tashmë në progres për të përmirësuar qëndrueshmërinë e BE-së dhe sigurinë e furnizimit me gaz, duke përfshirë një rregullore për ruajtjen e gazit, krijimin e një Platforme Energetike të BE-së për blerjet e përbashkëta dhe masat e listuara në REPowerEU.

Programi i 8-të i Veprimit për Mjedisin: BE-ja vendos të masë progresin në objektivat e "Marrëveshjes së Gjelbër"

Komisioni prezantoi një listë të treguesve kryesorë për monitorimin e progresit drejt objektivave mjedisore dhe klimatike të BE-së deri në vitin 2030, si dhe vizionin afatgjatë të vitit 2050 për të "jetuar mirë, brenda kufijve planetarë". Si rezultat i konsultimeve intensive me palët e interesuara dhe Shtetet Anëtare, Korniza e re e Monitorimit në kuadër të Programit të 8-të të Veprimit për Mjedisin synon të nxisë transparencën dhe të informojë evropianët për ndikimin e politikës klimatike dhe mjedisore të BE-së.

Politikat e BE-së duhet të sigurojnë që BE-ja të kthehet në rrugën e duhur për të jetuar dhe punuar brenda kufijve planetarë. Si të tillë, treguesit kapin progresin drejt mirëqenies mjedisore, duke përfshirë edhe aspektet ekonomike dhe sociale. Si të tilla, ato mund të hapin rrugën për matjen e shëndetit të ekonomive dhe shoqërive tona bazuar në mirëqenien, dhe përtej treguesit më të njohur ekonomik, PBB-së.

Zëvendës-Presidenti Ekzekutiv Frans Timmermans, i ngarkuar me Marrëveshjen e Gjelbër Europiane, tha: "Ne kemi objektiva shumë ambicioze mjedisore dhe klimatike për të na ndihmuar të realizojmë tranzicionin e drejtë të gjelbër për të cilin ka nevojë Europa dhe bota. Por atë që nuk mund ta matësh, nuk mund ta menaxhosh. Për të na mbajtur në rrugën e duhur, duhet të vëzhgojmë nëse po i përmbushim qëllimet tona. Këta tregues na ndihmojnë ta bëjmë këtë."

Virginijus Sinkevičius, Komisioneri për Mjedisin, Oqeanet dhe Peshkimin, tha: "Politikat janë po aq të mira sa zbatimi i tyre. Këta tregues kryesorë do të na ndihmojnë të ndjekim politikatat e dakorduara sipas Marrëveshjes së Gjelbër Europiane, duke hedhur dritë mbi tendencat dhe duke lehtësuar një diskutim të informuar midis politikëbërësve se ku nevojiten përpjekje të mëtejshme."

Treguesit kryesorë ndjekin strukturën e Programit të 8-të të Veprimit për Mjedisin, bazuar në Marrëveshjen e Gjelbër Europiane dhe përfshijnë 2-3 treguesit më të rëndësishëm dhe statistikisht të fortë për secilin nga objektivat prioritare tematike deri në vitin 2030, që mbulojnë zbutjen e klimës, përshtatjen klimatike, ekonominë rrethore, zero ndotje dhe biodiversitet.

Përveç kësaj, lista përfshin pesë tregues për të matur progresin drejt adresimit të presioneve kryesore mjedisore dhe klimatike. Në përputhje me objektivat e Marrëveshjes së Gjelbër Europiane, kjo mbulon tranzicionin që duhet të shohim në vitet e ardhshme drejt

sistemeve të qëndrueshme për energjinë, industrinë, lëvizshmërinë dhe ushqimin.

Për më tepër, grupi i titullit përfshin tregues për të monitoruar progresin drejt kushteve kryesore mundësuese, duke mbuluar financimin e qëndrueshëm, parimin "ndotësit paguajnë" dhe heqjen graduale të subvencioneve të dëmshme për mjedisin.

Kapitulli i fundit i kuadrit të monitorimit përfshin tregues sistematikë që synojnë të kapin progresin drejt tre dimensioneve të mirëqenies mjedisore, për të mbuluar edhe aspekte ekonomike dhe sociale përtej mbrojtjes së natyrës.

Hapat e ardhshëm

Komisioni do të raportojë çdo vit për progresin e bërë, bazuar në inventarizimin e bërë nga Agjencia Europiane e Mjedisit nga viti 2023 e në vazhdim, me ndihmën e treguesve kryesorë të përzgjedhur. Ky raportim do të lehtësojë një shkëmbim vjetor ndërmjet Komisionit, Shteteve Anëtare dhe Parlamentit European që do të mbahet në përputhje me Programin e 8-të të Veprimit Mjedisor.

Për më tepër, Komisioni do të kryejë dy vlerësime të thelluara gjatë jetëgjatësisë së programit - një rishikim afatmesëm në 2024 dhe një vlerësim përfundimtar në 2029.

Komisioni do të vazhdojë të promovojë koherencën midis treguesve kryesorë të Programit të 8-të të Veprimit për Mjedisin dhe mjeteve të tjera të monitorimit ndërsektorial, të tillë si Semestri European dhe monitorimi i BE-së mbi Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së.

Programi i 8-të i Veprimit për Mjedisin hyri në fuqi më 2 maj 2022 dhe përfshin një detyrim për Komisionin që të paraqesë një kuadër monitorimi, bazuar në një numër të kufizuar treguesish kryesorë. Këto duhet të përfshijnë, aty ku ka, tregues sistematikë që adresojnë ndërlidhjet ndërmjet konsideratave mjedisore-sociale dhe mjedisore-ekonomike të politikës, respektivisht.

EAP-ja e 8-të synon të përshpejtojë tranzicionin e gjelbër në një mënyrë të drejtë dhe gjithëpërfshirëse, me objektivin afatgjatë të vitit 2050 "Të jetosh mirë, brenda kufijve planetarë", të vendosur tashmë në programin e 7-të (2014-2020). Për më shumë se 40 vjet, këto programe veprimi i kanë ofruar BE-së korniza politikash që japin rezultate dhe sigurojnë veprim të parashikueshëm dhe të koordinuar për mjedisin dhe politikatat e ndryshimeve klimatike të Europës.

Armët e bërthamore, fuqia e njerëzimit për të shkatërruar të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen, fuqia për të sjellë fundin e kohës

Ekzistenca e armëve bërthamore paraqet një rrezik të qartë dhe të pranishëm për jetën në Tokë. Armët bërthamore nuk mund të forcojnë sigurinë e asnjë kombi, sepse ato përfaqësojnë një kërcënim për sigurinë e racës njerëzore.

Cili është i vetmi provokim që mund të sjellë përdorimin e armëve bërthamore? Armët bërthamore. Cili është objektivi prioritar për armët bërthamore? Armët bërthamore. Cila është mbrojtja e vetme e vendosur kundër armëve bërthamore? Armët bërthamore. Si të parandalojmë përdorimin e armëve bërthamore? Duke kërcënuar me përdorimin e armëve bërthamore. Ne nuk mund të heqim qafe armët bërthamore, për shkak të armëve bërthamore. Papajtuësmeria, me sa duket, është funksion i vetë armëve bërthamore.

Vala e Shpërthimit

Një pjesë e sekondës pas një shpërthimi bërthamor, nxehtësia nga topi i zjarrit bën që një valë me presion të lartë të zhvillohet dhe të lëvizë jashtë duke prodhuar efektin e shpërthimit. Pjesa e përparme e valës së shpërthimit, d.m.th., pjesa e përparme e goditjes, largohet me shpejtësi nga topi i zjarrit, një mur lëvizës me ajër shumë të ngjeshur.

Efektet e shpërthimit në struktura

Kjo sekuencë fotografike tregon një shtëpi me strukturë druri të ekspozuar ndaj një shpërthimi bërthamor në Zonën e Testimit të Nevadës. Testi ishte Upshot-Knothole Annie, një kullë 16 katesh e goditur, më 17 mars 1953. Shtëpia është 1 100 metra nga toka zero.

Ekspozimi ndaj rrezatimit termik ishte 25 cal/cm², rreth një e katërta e atij të përjetuar në pikën zero në Hiroshima.

Mbpresioni i shpërthimit ishte 5 psi, dhe vala e shpërthimit krijoi erëra sipërfaqësore prej 160 mph (milje në orë).

Ajri menjëherë pas pjesës së përparme të goditjes përshpejtohet në shpejtësi të larta dhe krijon një erë të fuqishme. Këto erëra nga ana e tyre krijojnë presion dinamik ndaj objekteve që përballen me shpërthimin. Valët goditëse shkaktojnë një kërcim praktikisht të menjëhershëm të presionit në pjesën e përparme të goditjes. Kombinimi i kërcimit të presionit (i quajtur mbipresion) dhe presionit dinamik shkakton dëme nga shpërthimi. Si presioni i tepërt ashtu edhe presioni dinamik arrijnë në vlerat e tyre maksimale me ardhjen e valës së goditjes. Më pas ato kalben gjatë një periudhe që varion nga disa të dhjetat e sekondës deri në disa sekonda, në varësi të fuqisë së shpërthimit dhe rendimentit.

Efektet e shpërthimit te njerëzit

Dëmtimi i shpërthimit shkaktohet nga ardhja e valës goditëse të krijuar nga shpërthimi bërthamor. Njerëzit në fakt janë mjaft rezistent ndaj efektit të drejtpërdrejt të presionit të tepërt. Presionet mbi 40 psi janë të nevojshme përpara se të vërehen efektet vdekjeprurëse.

Rreziku nga presioni i tepërt vjen nga shembja e ndërtesave që përgjithësisht nuk janë aq rezistente. Zonat urbane përmbajnë shumë objekte që mund të bëhen ajrore, dhe shkatërrimi i ndërtesave gjeneron shumë më tepër. Rënia e strukturës së mësipërme mund të shtypë ose mbytë ata që janë kapur brenda. Lëndimi i rëndë ose vdekja mund të ndodhë gjithashtu nga përplasja pasi është hedhur në ajër.

Efektet e shpërthimit në një ndërtesë betoni në Hiroshima

Shpërthimi gjithashtu zmadhon lëndimet e djegies nga rrezatimi termik duke shqyer lëkurën e djegur rëndë. Kjo krijon plagë të hapura të papërpunuara që infektohen lehtësisht.

Rrezatimi termik

Një formë primare e energjisë nga një shpërthim bërthamor është rrezatimi termik. Fillimisht, pjesa më e madhe e kësaj energjie shkon në ngrohjen e materialeve të bombës dhe ajrit në afërsi të shpërthimit. Temperaturat e një shpërthimi bërthamor arrijnë ato në brendësi të diellit, rreth 100,000,000 ° Celsius, dhe prodhojnë një top zjarri të shkëlqyer.

Dy impulse të rrezatimit termik dalin nga topi i zjarrit. Puls i parë, i cili zgjat rreth një të dhjetën e sekondës, përbëhet nga rrezatimi në rajonin ultravjollcë. Puls i dytë, i cili mund të zgjasë për disa sekonda, mbart rreth 99 për qind të energjisë totale të rrezatimit termik. Është ky rrezatim që është shkaku kryesor i djegieve të lëkurës dhe dëmtimeve të syve që pësojnë individët e ekspozuar dhe bën që materialet e djegshme të shpërthejnë në flakë.

Dëmtimi nga rrezatimi termik varet shumë nga kushtet e motit. Retë ose tymi në ajër mund të zvogëlojnë ndjeshëm diapazonin efektiv të dëmtimit kundrejt kushteve të ajrit të pastër.

Topi i zjarrit

Topi i zjarrit, një masë sferike jashtëzakonisht e nxehtë dhe shumë e shkëlqyeshme e mbetjeve të ajrit dhe armëve të gazta, ndodh brenda më pak se një milion të e një sekonde të shpërthimit të armës. Menjëherë pas formimit të tij, topi i zjarrit fillon të rritet në madhësi, duke përfshirë ajrin përreth.

Kjo rritje shoqërohet me një ulje të temperaturës për shkak të rritjes shoqëruese të masës. Në të njëjtën kohë, topi i zjarrit



Efektet e valës së shpërthimit në një shtëpi tipike me strukturë druri.

ngrihet, si një tullumbace me ajër të nxehtë. Brenda shtatë të dhjetave të një milisekondi nga shpërthimi, topi i zjarrit nga një armë 1 megaton është rreth 134.112 metër e gjerë, dhe kjo rritet në një vlerë maksimale prej rreth 1737.36 metër në 10 sekonda. Më pas rritet me një shpejtësi prej 250 deri në 106.68 metër në sekondë. Pas një minute, topi i zjarrit është ftohur në atë masë sa nuk lëshon më rrezatim të dukshëm. Më pas është ngritur afërsisht 4.5 milje nga pika e shpërthimit.

Reja si kërpudhë

Ndërsa topi i zjarrit rritet në madhësi dhe ftohet, avujt kondensohen për të formuar një re që përmban grimca të ngurta të mbeturinave të armëve, si dhe shumë pika të vogla uji që rrjedhin nga ajri i thithur në topin e zjarrit në rritje.

Në varësi të lartësisë së shpërthimit, krijohet një tërheqje e fortë lart me erëra që rrjedhin, e quajtur "pas erërave". Këto erëra të mëvonshme mund të shkaktojnë thithjen e sasive të ndryshme të papastërtive dhe mbeturinave nga sipërfaqja e tokës në re. Në një shpërthim ajri me një sasi të moderuar (ose të vogël) papastërtie dhe mbeturinash të tërhequra në re, vetëm një pjesë relativisht e vogël kontaminohet me radioaktivitet. Megjithatë, për një shpërthim afër tokës, sasi të mëdha papastërtie dhe mbeturinash tërhiqen në re gjatë formimit.

Ngjyra e resë fillimisht është e kuqe ose kafe e kuqërremtë, për shkak të pranisë së acidit azotik dhe oksideve të azotit. Ndërsa topi i zjarrit ftohet dhe ndodh kondensimi, ngjyra ndryshon në të bardhë, kryesisht për shkak të pikave të ujit (si në një re të zakonshme).

Reja përbëhet kryesisht nga grimca shumë të vogla të produkteve të ndarjes radioaktive dhe mbetjeve të armëve, pika uji dhe grimca më të mëdha të papastërtive dhe mbeturinave të bartura nga erërat e mëvonshme.

Lartësia eventuale e arritur nga reja radioaktive varet nga energjia termike e armës dhe nga kushtet atmosferike.

Reja arrin lartësinë e saj maksimale pas rreth 10 minutash dhe më pas thuhet se është "stabilizuar". Ajo vazhdon të rritet anash, megjithatë, për të prodhuar formën karakteristike të kërpudhave. Reja mund të vazhdojë të jetë e dukshme për rreth një orë ose më shumë përpara se të shpërndahet nga erërat në atmosferën përreth, ku bashkohet me retë natyrore në qiell.

Efektet e pulsit termik

Një nga ndryshimet e rëndësishme midis një arme bërthamore dhe asaj konvencionale është përqindja e madhe e energjisë së një shpërthimi bërthamor që lëshohet në formën e energjisë termike. Kjo energji emetohet nga topi i zjarrit në dy pulse. E para është mjaft e shkurtër dhe mbart vetëm rreth 1 për qind të energjisë; puls i dytë është më domethënës dhe zgjat më shumë (deri në 20 sekonda).

Energjia nga puls i termik mund të shkaktojë zjarre në mate-

riale të thata, të ndezshme, të tilla si gjetet e thata, bari, gazeta e vjetër, pëlhuara të holla të ndezshme të errëta, etj. Efekti ndezës i pulsit termik ndikohet gjithashtu ndjeshëm nga ardhja e mëvonshme e shpërthimit valë, e cila zakonisht nxjerr çdo flakë që tashmë është ndezur. Megjithatë, materiali që digjet mund të rindizet më vonë.

Efekti kryesor ndezës i shpërthimeve bërthamore shkaktohet nga vala e shpërthimit. Strukturat e shembura janë shumë më të ndjeshme ndaj zjarrit sesa ato të paprekura. Shpërthimi redukton shumë struktura në grumbuj ndezësish, boshllëqet e shumta të hapura në çati dhe mure veprojnë si oxhaqe, linjat e gazit janë thyer të hapura, rezervuarët e magazinimit për materialet e ndezshme janë çarë. Burimet kryesore të ndezjes duket se janë flakët dhe dritat pilot në pajisjet e ngrohjes (furra, ngrohës uji, soba, etj.). Materiali i shkrire nga puls i termik mund të jetë shumë efektiv në ndezjen e gazit që rrjedh.

Rrezatimi termik gjithashtu prek njerëzit si drejtpërdrejt, nga djegiet e ndezura në lëkurën e ekspozuar, dhe indirekt, nga zjarret e shkaktuara nga shpërthimi.

Stuhitë e zjarrit

Në disa kushte, shumë zjarre individuale të krijuara nga një shpërthim bërthamor mund të bashkohen në një zjarr masiv të njohur si "stuhi zjarri". Kombinimi i shumë zjarreve më të vogla ngroh ajrin dhe shkakton erëra me forcë uragani të drejtuara nga brenda drejt zjarrit, të cilat nga ana e tyre ndezin flakët. Që të zhvillohet një stuhi zjarri:

- Duhet të ketë të paktën 3.6 kg lëndë djegëse për metër katror.

- Të paktën gjysma e strukturave në zonë janë në zjarr në të njëjtën kohë.

- Fillimisht fryn një erë më pak se 8 milje në orë.

- Zona e djegies është të paktën 0,5 milje katrore.

Në Hiroshima, një stuhi zjarri u zhvillua dhe rreth 7 km katrorë u shkatërruan. Megjithëse pati disa dëme nga zjarret e pakontrolluara në Nagasaki, një stuhi zjarri nuk u zhvillua. Një arsye për këtë ishte ndryshimi në terren. Hiroshima është relativisht e sheshtë, ndërsa Nagasaki ka terren të pabarabartë.

Stuhitë e zjarrit mund të shkaktohen edhe nga bombardimet konvencionale. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, qytetet e Dresdenit, Hamburgut dhe Tokios pësuan të gjitha efektet e stuhive të zjarrit.

Djegiet e lëkurës

Djegiet janë një nga pasojat e rënda të një shpërthimi bërthamor. Djegiet e lëkurës vijnë nga thithja e energjisë rrezatuese nga lëkura e individëve të ekspozuar. Një tipar dallues i djegieve të tilla lëkurës është fakti se ato janë të kufizuara në zonat e ekspozuara të lëkurës përballë shpërthimit.

Djegiet janë një model që korrespondon me pjesët e errëta të kimonos që ajo kishte veshur në momentin e shpërthimit.

Një shpërthim prej 1 megaton mund të shkaktojë djegie të shkallës së parë (një djegie të keqe nga dielli) në një distancë prej rreth 7 milje, djegie të shkallës së dytë (duke prodhuar flluska dhe plagë të përherëshme) në distanca rreth 6 milje, dhe djegie të shkallës së tretë (të cilat shkatërrojnë indet e lëkurës) në distanca deri në 5 milje. Djegiet e shkallës së tretë mbi 24 për qind të trupit, ose djegiet e shkallës së dytë mbi 30 për qind, do të rezultojnë në tronditje serioze dhe ndoshta do të rezultojnë fatale nëse nuk ofrohet kujdes i shpejtë dhe i specializuar mjekësor.

Ky pacient (i fotografuar nga forcat japoneze më 2 tetor 1945) ishte rreth 6500 këmbë nga toka zero kur rrezet e goditën atë nga e majta. Kapaku i tij ishte i mjaftueshëm për të mbrojtur pjesën e sipërme të kokës kundër djegieve.

Është vlerësuar se djegiet shkaktohen rreth 50 për qind të vdekjeve në Hiroshima dhe Nagasaki.

Verbëri

Verbëria nga shpërthimi shkaktohet nga ndezja fillestare e shkëlqyeshme e dritës e prodhuar nga shpërthimi bërthamor. Drita merret në retinë sa mund të tolerohet, por më pak se sa kërkohet për lëndime të pakthyeshme. Retina është veçanërisht e ndjeshme ndaj dritës infra të kuqe të dukshme dhe me gjatësi vale të shkurtër. Rezultati është një zbardhje e pigmentit vizual dhe verbëri e përkohshme. Vizioni rikuperohet plotësisht pasi pigmenti rigjenerohet.

Gjatë orëve të ditës, verbëria nga shpërthimi nuk zgjat më shumë se 2 minuta, por në përgjithësi zgjat disa sekonda. Natën, kur bebëza është e zgjeruar, verbëria e ndezjes do të zgjasë për një periudhë më të gjatë kohore.

Një shpërthim prej 1 megaton mund të shkaktojë verbëri me blic në distanca aq të mëdha sa 13 milje në një ditë të pastër ose 53 milje në një natë të pastër. Nëse intensiteti është mjaft i madh, do të rezultojë një djegie e përherëshme e retinës.

Lëndimi i retinës është efekti më i gjerë i dëmtimit të shpërthimeve bërthamore, por është relativisht i rrallë pasi syri duhet të shikojë drejtpërdrejt shpërthimin. Lëndimi i retinës rezulton nga djegiet në zonën e retinës ku fokusohet imazhi i topit të zjarrit.

Dasmat shqiptare, autenticitet, vlerë, trashëgimi kulturore

Shumë tradita të dasmës shqiptare kohët e fundit janë harruar. Ato ndryshojnë nga rajoni në rajon, mirëpo në përgjithësi kanë të njëjtën zanafillë. Mënyra se si dasma festohej para 50 vitesh ndryshon nga metodat e sotme. Shumë gjenerata sigurisht as nuk e dinë se si kremtohej detajisht një martesë dikur dhe cilat janë disa nga karakteristikat e dasmës shqiptare. Më poshtë ne po përmendim disa prej tyre duke u përpjekur të bëjmë një krahasim me ditët e sotme.

Kohëzgjatja e festës

Sipas zakonit shqiptar dasma zgjaste 5 ditë. Ajo nisej me përgatitjen e kulaçit të dasmës. Festën, dasmorët e dhëndrit e vazhdonin edhe të premtën si dhe të shtunën. Të shtunën bëhej nata e dasmës. E diela ishte dita e dasmës dhe marrja e nuses me krushqi. Kurse të hënën ishte "dita e grave". Kryesisht tashmë gjatë dasmës shqiptare mbahet vetëm dita e dasmës. Marrja e nuses dhe festa e madhe në mbrëmje.

Përgatitjet dikur dhe sot

Përderisa dikur dasmat shqiptare mbaheshin në ambientet shtëpiake dhe në oborre, sot ato kryesisht janë të zhvendosura në restorante. Kjo bën që përgatitjet për dasma dikur dhe sot të dallojnë shumë. Organizatorët e dasmës dikur kujdeseshin për adaptimin e shtëpive për festë. Gratë gatuanin vet në një pjesë të oborrit. Pastrimi merrte shumë ditë gjithashtu. Sot organizimi brenda lokalit bëhet shumë më shpejt dhe me standarde të larta, aq sa shpesh merr vëmendjen më të madhe të të pranishmëve.

Veshjet dhe përgatitjet e nusërisë

Veshjet e nusërisë ishin pjesë e rëndësishme e dasmës por edhe e rinisë së vajzave. Ato ishin kryesisht punëdore. Vajzat i punon disa prej tyre vetë e disa nënat e tyre apo gratë e tjera. Në secilën ditë të dasmës veshja e nuses ishte ndryshe. Kurse në anën tjetër, në ditët e sotme nuset çdo ditë e më pak përdorin veshje tradicionale. Ato veshin në ditën e dasmës së tyre fustanin e bardhë të nusërisë që vishet në ditën e dasmës në shumicën e vendeve të botës.

Fejesa, trampolina drejt martesës

Martesa në traditën popullore shqiptare është konsideruar nga zakonet më të dëshiruara, një zakon gëzimi, ajo ka sublimuar kalimin e disa fazave të jetës deri në pjekurinë për punë e jetë dhe, mbi të gjitha, për shumim. Këtij zakoni familjar i paraprijnë rritja e suksesshme e fëmijës së shëndoshë dhe të përgatitur për jetë, kalimin në fazën e pjekurisë për martesë, për fejesën dhe vetë aktin e martesës.

Fejesa si akt ceremonial, që përcakton publikisht personat që, pas martesës, do të krijonë jetën bashkëshortore.

Si e tillë, fejesa është e mbushur me plot veprime e ceremoni rituale, disa të trashëguara nga lashtësitë e mugëta pagane, po disa më të vona - edhe me rite islame a të krishtera, në varësi nga besimi. Sipas traditës, është bërë me shkuesi, por më përpara ishte traditë më pak e rastësishme edhe fejesa në bark dhe fejesa në djep, raste këto të trashëguara nga traditat pagane para-islame. Në të dy rastet, bëhej nga pjesëtarët e familjes: babai, nëna, i zoti i shtëpisë e, më rrallë, e zonja e shtëpisë, por vetëm në raste kur dëshirohej të trashëgohej miqësia e mirë e dyanshme, ose shoqëria e fortë në luftë e dy burrave, po edhe e nënave, të njohura në ditë gëzimsh e hidhërimesh, me pëlqimin e dyanshëm, pa marrë parasysh se cili do jetë marrës e cili dhënë.

Kjo traditë tashmë ka perënduar, me përjashtime të ndërhyrjeve më tepër formale, nga ndonjë i afërm ose shok, në rolin "e mblesit", pasi çifti i ri të ketë vendosur për jetë bashkëshortore. Akti përfundimtar i martesës është dasma (në shtëpinë e dhëndrit) dhe kanaxheci (në shtëpinë e vajzës) Në të dy rastet këtë gëzim e organizojnë burrat, sipas traditës, por edhe femra është pjesëmarrëse aktive, sidomos në punët që u përkasin grave. Dasmat tradicionale zgjatnin tri ditë e net dhe organizoheshin për të marrë nusen ditën e hënës ose të enjtes. Të martave marthoheshin të vejat, me më së shumti 7 krushq. Në kohën tonë nuk veprohet kështu. Të gjitha ditët e javës janë ditë dasmash.

Stinë më të parapëlqyera të traditës për martesë ishin vjeshta dhe pranvera, një traditë tashmë e tejkaluar, dasmat bëhen gjatë gjithë vitit.



Disa faza për realizimin e dasmës në vite:

- faza përgatitore;
- fillimi i dasmës;
- nata e dasmës;
- dita e dasmës dhe
- përfundimi i dasmës.

a) Në fazën përgatitore hyjnë të gjitha punët, derisa të fillojë dasma, do të thotë deri ditën e premtë (kur nusja merret të hënën), ose të enjtes (kur nusja merret ditën e diel). Në këto punë hyjnë të gjitha konsultimet me pjesëtarët të familjes, vëllazërisë apo fshatit për: mënyrën e organizimit të dasmës; vendin ku do të priten miqtë - dasmorët; ftesën e dasmorëve; ditën e dasmës; sigurimin e druve për dasmë; rregullimin e odës së krushqve; pritjen e miqve dhe sidomos të atyre më të largëtëve; bajraktarin e dasmës; pritësit; hyzmeqarët; kafexhiun; akcinë; odabashin; shërbyesit e tjerë dhe mbajtësit e rendit; muzikantët, etj..

b) Fillimi i dasmës konsiderohet dita e kulaçit dhe fillimi i tëhollimit të petëve - gatimi, që shoqërohet me kërcime para defit të një djali, sa për t'ia filluar, i cili sit



pak miell nga mielli i tëhollimit të petëve. Këtu pra kemi një lloj besëtytnie: djali e sit miellin në mënyrë që edhe nusja, sipas besimit të tyre, të lindë djem, edhe ky është një rit me bazë pagane si shumë të tjera që, me dije apo pa të, zbatoheshin në masë të madhe në traditën shqiptare, por dita ditës po bëhen më të zbehta. Dasmën e vazhdojnë këtë ditë para dreke me të kërcyer hallat e bijat, duke kënduar këngë dasme, për djalin që martojnë.

c) Natën e dasmës fillon ardhja e dasmorëve, miqve - të ftuarve në dasmë dhe ata vendosen: burrat në odë, në vendin e caktuar në shtëpi të dhëndrit. Në orë më të vona të kësaj dite nipat fillojnë të zënë pula, kudo që i hasin nëpër lagje dhe i therin e ua japin vajzave dasmore për t'ua fërguar. Edhe ky një gabim, ngase bëhet fjalë për "vjedhjen e tyre". Ndërkaq, vajzat bëjnë gati kulaçin e nuses në prani të një djali, të cilit ia vënë tre plisa në kokë, si simbol i shtimit të meshkujve nga martesa që po bëhet në atë shtëpi.

Mënyra e marrjes së nuses



Dasmor, sipas tradite mund të ishte vetëm burri që i kishte dalë zot pushkës, që domethënë fëmijët nuk merreshin krushq.

Krushqve u prinin dy burra të moshës së mesme, të cilët dilnin para bajraktarit, pastaj vinin bajraktari, kleri (hoxha tek myslimanet ose prifti tek katolikët), prapa tij krushqit e tjerë. Kur nusja merret me kalë, kalin e shoqëronin katër persona: dy përpara, që mbanin kalin për freri nga të dy anët, dhe dy shoqërues prapa tyre, por anash kalit. Krushqit e tjerë vinin këmbë në rend njëri pas tjetrit. Ndërkaq, kur nusja merret me qerre kuajsh, krushqit shkonin hipur në qerre. Në rrugën për ta marrë nusen, qerrja e nuses duhej të nisej disa minuta deri një orë para krushqve, në varësi nga largësia, në mënyrë që në shtëpinë e vajzës të kthehej drekë për krushkat derisa e bënin nusen gati dhe derisa ngarkonin (pajën) në qerre. Në të kthyer nga miku, qerrja e nuses dhe, prapa saj e pajës, vinin pas krushqve. Me t' u nisur krushqit nga shtëpia e dhëndrit për ta marrë nusen, këngëtarët u prinin dasmorëve me këngë të zonës së tyre. Me këngë edhe hynin edhe dilnin nga fshati, këngë këto të pashoqëruara me instrumente muzikore, aty ku merret nusja si dhe me të arritur në fshatin e dhëndrit. Si në nisjen e në arrijten e krushqve, ashtu edhe në të hyrë të fshatit të mikut e në të dalë prej tij, ishte traditë që dasmorët-krushqit të shtinin në ajër me armë zjarri. Ishte traditë po ashtu të thyhej udha në të kthyer të krushqve. Dhëndri, sipas traditës, derisa krushqit shkonin për t'ia marrë nusen, bënte ritualin e pastrimit dhe përgatitjet për fazën e iniciacionit. Ardhjen e nuses e priste i fshehur në objekte të oborrit të shtëpisë, nga një vend më i lartë se nusja dhe prej nga e vrojtonte nusen gjatë zbritjes nga qerrja. Ceremonia e dasmës vazhdon edhe këtë natë me përrurime për babanë dhe të zotin e shtëpisë. Dhëndri në odë burrash hynte për herë të parë pas ardhjes dhe zbritjes së nuses nga qerrja, kur dasmorët do t' i uronin martesën. Dasmorëve u jepej çaj ose kafe. Duke hyrë në gjerdek, dhëndri shoqërohet nga bashkëmohatarët të tij, të cilët e godasin me grushte (një nga ritet më të hershme të kohës pagane). Të nesërmen dhëndri zgjohet herët në mëngjes, i veshur me rroba dhëndërie, si një shenjë që ai tashmë është ndarë nga mjedisi i tij social dhe i takon një grupi tjetër, atij të burrisë. Kemi të

bëjmë pra me kalimin nga një fazë e jetës në tjetrën, që njihet si iniciacion.

Nga ajo që shohim e dëgjojmë sot, kanë mbetur pak rituale nga tradicionalja dhe kemi një ndryshim shumë të madh në ceremoninë martesore tek ne shqiptarët.

Dhuratat, nusja fal shami e çorape leshi

Po cilat ishin zakonet për vizitat e para mes dy palëve të krushqve të ardhshëm? Nga ana e burrit vinte xhaxhai dhe daja i dhëndrit, bashkë me kryefamiljarin. Pra, linja më e afërt e dhëndrit.

Sigurisht, që krushqit e dhëndrit do ta bënin vizitën të parët në shtëpinë e nuses, ku do të kërkonin dhe dorën e vajzës për djalin e tyre.

Ata duhej të rrinin jo më tepër se dy orë në shtëpinë e nuses dhe pas urimeve dhe gostisë, ktheheshin në shtëpi.

Nganjëherë, sipas rastit, shkonin edhe për darkë. Si dhurata fejesë, zakonisht çohet bukë me qiçër, çorape të leshta, këmishë, etj.

Kurse nusja, sipas zakonit, i jepte shami fëmijëve dhe i puthte, dërgonte çorape leshi të bëra me duart e saj për dhëndrin, vjehrrin, kunetërit, xhaxhallarët dhe dajat e dhëndrit. Veç këtyre, çoheshin edhe jorganë, çorga, lenvenxa, veshmbathje, e kështu me radhë...

Nata e parë, nusja me dhëndrin flenë të ndarë

Natën e parë, asnjëherë nusja nuk flinte me dhëndrin. Pasi ajo hidhte vallen me dhëndrin e mbaronte dhe festa, shkonin e flinin; nusja në dhomën e grave e dhëndri në atë të burrave.

Kumbari, më i rëndësishmi ndër të gjithë

Asnjëherë nuk ndodhte, që kurora të vihej pa praninë e kumbarit. Madje, kur nusja merret, ajo duhet të kërkohet në praninë e kumbarit dhe me mirëkuptimin e tij.

E, teksa nusja rrinte në shtëpinë e saj në krye të këndit, kumbari ftohej që të enjten, tri ditë para se të bëhej dasma.

Kur njerëzit e dhëndrit nisen për të marrë nusen, ata duhet që të flasin në fillim me kumbarin e të bien dakord me të dhe së bashku, shkojnë e marrin nusen që të vënë kurorën.

Njerëzit e nuses, janë të detyruar të shkojnë gjithmonë 2 më shumë sesa kanë ardhur njerëzit e dhëndrit tek nusja.

Maskat trembin nusen, para valles në mesnatë

Një veçanti tjetër që e kishin dasmat e zhvilluara kryesisht në Korçës, ishte ajo e maskimit të dasmorëve dhe lojërave që bëjnë ata me krushqit dhe gjithë të pranishmit e tjerë, për të nxehur më tepër atmosferën, teksa afron dhe vallëzimi i parë i nuses.

"Diku andej nga mesi i dasmës, ka dasmorë që vishen me maska, si palaço, me fytyra e veshje të ndryshme grash apo burrash, për të bërë qyfyre e për të nxehur atmosferën, sepse pas këtij momenti, nusja ngrihet në vallen e parë.

Kjo, zakonisht ndodh pas orës dy të natës".

Përplasja e dy dasmave dhe "Varri i Krushqve"

Kur ndodhte që të kishte dy dasma në të njëjtën ditë dhe karvanët e krushqve, bashkë me nusen kryqëzoheshin me njëra-tjetrën, askush prej tyre nuk hapte rrugë, se dasma i vinte ters, e veç të tjerash, hapja e rrugës do të ishte dhe një ulje për fiset që lëshonin fill në këtë mes.

Lidhur me këtë zakon, ka dhe një legjendë, sipas së cilës, në disa fshatra afër Vithkuqit ekzistojnë disa varre, të cilat quhen "Varret e Krushqve".

Nuk dihet me saktësi nëse legjenda ka lidhje me të vërtetën, pasi këto kërkohen kohë më të gjatë investigimi dhe punë shkencore, por ajo që realisht ka ndodhur në atë zonë është se një ditë të bukur, dy karvanë dasmorësh që çonin nuset për në shtëpinë e dhëndrit janë përballur dhe asnjëra palë nuk tërhoq prapa, askush nuk donte të hapte rrugë, gjë që solli një tragjedi dhe i ktheu dy dasma në dy varreza të mëdha.

Meqenëse këto lloj përplasjesh mund të ndodhnin për shkak se dasmat mund bëheshin midis dy familjeve nga zona tepër të largëta me njëra-tjetrën e gjithashtu dasmat zhvilloheshin në muajin e vjeshtës, atëherë, gjithkush nga shtëpia e dhëndrit që shikonte për së largu në horizont, karvanin me krushqit dhe nusen hipur në kalë teksa arrinin shëndoshë e mirë, jepte lajmin duke qëlluar në ajër.

Krismat më tej pasoheshin nga dhëndri, që donte të tregonte se tashmë nusja dhe karvani, ishin të sigurt nën mbrojtjen familjes së tij...

Historia njëshekullore me botën e kombeve të lira

Data 28 korrik 2022, shënon 100-vjetorin e njohjes së Shqipërisë nga SHBA-të dhe vendosjen e marrëdhënieve diplomatike. Marrëdhënie këto që pas atij lulëzimi do të pësonin edhe "goditjen" më të rëndë, me ardhjen e komunistëve pas Luftës së Dytë Botërore, me ardhjen e Enver Hoxhës, marrëdhëniet diplomatike me Shtetet e Bashkuara u ndërprejnë prej 45 vitesh, si rezultat i vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri, ku do të ishte ardhja e demokracisë, ajo që do të shënonte edhe me hapjen e Ambasadës Amerikane në Tiranë, më 1 tetor 1991, edhe ri-vendosjen e marrëdhënieve të shkëlqyera.

Ish-Sekretari i Shtetit, James Becker, do të ishte zyrtari i parë i nivelit të lartë i SHBA-ve, që do të vizitonte Shqipërinë, pas periudhës së gjatë të izolimit dhe që do të përcillte mesazhin aq të ëndërruar prej shqiptarëve: "Mirë se vini në botën e kombeve të lira".

Marrëdhëniet midis vendeve tona datojnë në fillimet e shekullit të kaluar, në kohën kur Mbreti i shqiptarëve, Zogu i Parë, dhe Presidenti i SHBA-ve Woodrow Wilson, të cilin Shqipëria i dedikon jo pak, por ekzistencën e saj. Një gjest i rëndësishëm ky në Konferencën e Paqes, në Londër, i cili nuk u harrua kurrë nga mijëra amerikanët me origjinë shqiptare, të cilët mbajtën kontaktet me atdheun e tyre përgjatë gjithë këtyre viteve.

Nuk mund të lemë pa përmendur kontributin e Presidentit Bush, i cili udhëhoqi rrëzimin e "Perdes së Hekurt" dhe vendosjen e demokracisë në vendet ish-komuniste, një prej të cilave ishte dhe Shqipëria, rolin e padiskutueshëm të Presidentit Clinton, të zonzës së madhe Albright, që çuan në ndërhyrjen ushtarake të NATO-s në Kosovë, dhe rrugën që ndoqi administrata Obama, që e kristalizuan më tej provën e miqësisë së thellë shqiptaro-amerikane. Për herë të parë në historinë mijëvjeçare të kombit tonë, superfuqia e botës dhe vendet më të fuqishme europiane, anëtare të NATO-s, u radhitën përkrah popullit shqiptar në dy anët e kufirit, duke e shpëtuar atë nga një kasaphanë që nuk njihje kufij.

Marrëdhëniet diplomatike mes Shqipërisë dhe SHBA-së e kanë pikënisjen më 28 korrik të vitit 1922, kur ende shteti shqiptar sapo kishte ri-konfirmuar pavarësinë.

Vendimi për lidhjen e marrëdhënieve diplomatike me Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka ardhur natyrshëm pas vetos që presidenti amerikan Thomas Woodrow Wilson vuri në konferencën e Paqes në Paris duke i rikthyer pavarësinë Shqipërisë.

Presidenti pasardhës i Wilson-it, Warren Harding, emëroi si ambasador të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë, Ulysses Grant Smith, i cili e nisi misionin diplomatik më 4 Dhjetor 1922. Një diplomat që jo thjesht vuri gurin e parë kilometrik në një rrugë të gjatë të marrëdhënieve, por që ishte njëkohësisht i pari që ndriçoi shtetin amerikan se çfarë ishte Shqipëria çfarë ishin shqiptarët dhe si mund ta ndihmonte Amerika Shqipërinë.

"Ky vend është shumë i varfër, njerëzit në përgjithësi janë të pashkolluar dhe të paushqyer, por çuditërisht përpara meje ndodhet kryeministri Fan Noli, i cili flet një anglishte harvardiane shumë më të mirë nga mua. Dhe unë ndjem keq përpara tij", - shkruan Smith në kujtimet për punën si ambasador në vendin tonë.

Deri në vitin 1939 Shqipëria ishte thjesht një komb i preferuar për SHBA-në aq sa dhjetëra amerikanë vërshuan në vendin tonë jo vetëm si diplomatë, por edhe si biznesmenë, themeluesë shkollash e deri në investitorë ekspeditash për të zbuluar pasuritë e nëntokës sonë.

Kjo do të vazhdonte deri në vitin 1939 kur Shqipëria e humbi pavarësinë e saj pas pushtimit të vendit nga Italia dhe largimit të Mbretit Zog me familjen nga vendi.

Ambasadori amerikan në atë kohë në Tiranë, Hugh Grant, i ofroi tre pasaporta amerikane Zogut: një për vete, një për mbretëreshën Geraldinë dhe një për Lekën e sapolindur, të cilat u refuzuan nga ai.

Ambasada amerikane në Tiranë, u mbyll zyrtarisht më 16 shtator 1939, ndërsa diplomati Grant u largua më 27 Shtator.

Me ardhjen e komunistëve në pushtet, për 52 vjet asnjë diplomat amerikan dhe shqiptar nuk vuri këmbë në Shqipëri dhe në SHBA.

Vetëm 3 muaj pasi ishte rihapur ambasada, më 21 qershor 1991, Sekretari Amerikan i Shtetit, James Baker, do të vizitonte Tiranën. Me mijëra shqiptarë mbushën sheshin "Skënderbej", duke i rezervuar atij një pritje madhështore, e ngulitur në memorien e të gjithëve.

Marrëdhëniet shqiptaro-amerikane do ta shënonin kulmin e tyre me vizitën historike të Presidentit George W. Bush, më 10 Qershor 2007, e para e një presidenti amerikan në Shqipëri. Pamjet e qytetarëve të Fushë-Krujës duke u shtyrë për të përqafuar presidentin Bush, i cili përballë entuziazmit të qytetarëve theu rregullat e sigurisë, do të ktheheshin në lajmin kryesor të televizioneve amerikane.

Në kuadrin e këtyre marrëdhënieve duhet theksuar se ka qenë qëndrimi i vendosur dhe angazhimi i Presidentit Bush dhe gjithë administratës që ai drejtoi, që zgjidhja e statusit të Kosovës të mos shtyhet pafundësisht dhe që Kosova të fitojë pavarësinë. Dhe kjo kulmoi në vizitën e parë të tij, kur nga Tirana Presidenti në detyrë George W. Bush deklaroi se Kosova do të jetë e pavarur, dhe kështu ndodhi, më 17 Shkurt 2008, Kosova shpalli pavarësinë e saj nga Serbia, dhe ishin Shtetet e Bashkuara që u radhitën ndër shtet e para që e njohën pavarësinë e Kosovës.

Marrëdhëniet bilaterale të Shqipërisë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, konsiderohen të rëndësishme parësore për politikën e jashtme të Shqipërisë.

Një vlerësim i mirënjohjes së kombit shqiptar për rolin e rëndësishëm që SHBA-të, kanë luajtur që nga njohja e shtetit shqiptar e deri në ditët e sotme, inkurajim për të vazhduar kursin e nisur të reformave, falënderim për kontributin e vendit tonë në luftën kundër terrorizmit, mbështetje për përpjekjet tona për integrimin në NATO, konfirmim i rolit të pazëvendësueshëm të SHBA-së në zgjidhjen e statusit të Kosovës. Prej nga dita e parë e këtyre lidhjeve, që zënë fill në kohën e Mbretërisë Shqiptare, Mbretit Zog I, e cila qe e para ajo që gjeti



mikun e saj të përjetshëm e deri më sot, ishin ambasadorët amerikanë ata që e çuan deri në zenit, lidhjen mes SHBA-së dhe Shqipërisë.

Ata ishin: Ulysses Grant-Smith (Ministër 1922-25), Charles C. Hart (Ministër 1925-29), Herman Bernstein (Ministër 1930-33), Post Wheeler (Ministër 1933-34), Hugh Gladney Grant (Ministër 1935-39), William Edwin Ryerson (Ambasador 1991-94), Joseph Edward Lake (Ambasador 1994-96), Marisa R. Lino (Ambasadore 1996-99), Joseph Limpinrecht (Ambasador 1999-2002), James Jeffrey, Marcie Rice, John Wither, Alexander Arvizu, dhe ambasadorja në detyrë, Yuri Kim.

Konsujt amerikanë në Vlorë dhe Tiranë

Vlorë: Joseph E. Haven (Konsull 1919); Tiranë: George C. Minor (Zëvendës Konsull 1927-29), Royal R. Jordan (Zëvendës Konsull 1929), Paul H. Demille (Zëvendës Konsull 1931-32), Erich W. A. Hoffmann (Zëvendës Konsull 1932-38), Robert L. Hunter (Zëvendës Konsull 1938), Morris N. Hughes (Konsull 1938).

LISTA E AMBASADORËVE NË SHQIPËRI

Yuri Kim

Yuri Kim mbërriti në Tiranë si Ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Republikën e Shqipërisë në janar 2020. Ambasadorja Kim, një diplomate karriere, ka punuar mbi sfida kyçe të politikës së jashtme dhe sigurisë kombëtare në mbarë Europën, Azinë dhe Lindjen e Mesme. Ka qenë drejtoreshë e Çështjeve të Europës Jugore dhe ka mbuluar Turqinë, Greqinë, Qipron dhe më gjerë rajonin e Mesdheut Lindor; si drejtoreshë e Zyrës së Çështjeve Europiane të Sigurisë dhe ato Politikë-Ushtarake, ka mbuluar NATO-n dhe Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE). Më parë ka qenë Shefe e Kabinetit e Zëvendës Sekretarit të Shtetit dhe drejtoreshë e Qendrës për Studimin e Administrimit të Diplomacisë. Më herët në karrierën e saj ka qenë Ndihmëse e Posaçme e Sekretarit të Shtetit Colin Powell, si dhe Ndihmëse e Posaçme e Ndihmës Sekretarit të Shtetit për Çështjet e Azisë Lindore dhe Paqësorit. Mandatet e saj jashtë SHBA-ve përfshijnë Turqinë, Irakun, Republikën e Koresë, Japoninë dhe Kinën. Yuri Kim ka një diplomë Bachelor nga Universiteti i Pensilvanisë dhe një Master në Filozofi nga Universiteti i Kembrixhit.



Alexander Arvizu

Alexander Arvizu, ka qenë ambasadori më jetëgjatë i Shteteve të Bashkuara në Tiranë. Alexander A. Arvizu një diplomat i SHBA-ve, i cili shërbeu si ambasador amerikan në Shqipëri, lindi në bazën e ushtrisë amerikane në Japoni. Babai i tij është me origjinë nga Dolores Hidalgo, Meksikë dhe e ëma ishte nga Kyoto, Japoni. Në vitin 1980 ai u diplomua në Universitetin e Georgetown. Ai ka studiuar gjuhë të ndryshme aziatike si gjuhën japoneze, koreane, thai dhe khmer.



John L. Withers II

Shteti i Rezidencës: Maryland. Zyrtar i Shërbimit të Huaj, Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe i Plotfuqishëm, i emëruar më 28 Korrik, 2007. Prezantimi i letrave kredenciale: 25 Gusht 2007
Përfundimi i Misionit 18 Gusht, 2010.



Marcie B. Ries

Shteti i Rezidencës: Distrikti i Kolumbia-s. Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe i Plotfuqishëm i emëruar më 18 Tetor, 2004. Prezantimi i letrave kredenciale: 30 Tetor, 2004.



James F. Jeffrey

Shteti i Rezidencës: Virxhinia. Zyrtar i Shërbimit të Huaj. Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe i Plotfuqishëm i emëruar më 3 tetor 2002. Prezantimi i letrave kredenciale: 22 tetor, 2002. Përfundimi i Misionit: më 2 maj, 2004.



Joseph Limpinrecht

Shteti i Rezidencës: Virxhinia. Zyrtar i Shërbimit të Huaj. Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe i Plotfuqishëm i emëruar më 7 korrik, 1999. Prezantimi i letrave kredenciale 8 shtator, 1999. Përfundimi i Misionit: Ka vdekur në veri të Shqipërisë, 19 maj, 2002.



Marisa R. Lino

Shteti i Rezidencës: Oregon. Zyrtare e Shërbimit të Huaj. Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe i Plotfuqishëm i emëruar më 2 korrik 1996.

Prezantimi i letrave kredenciale: 4 shtator, 1996. Përfundimi i Misionit: më 20 maj, 1999.



Joseph E. Lake

Shteti i Rezidencës: Teksas. Zyrtar i Shërbimit të Huaj. Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe i Plotfuqishëm i emëruar më 5 korrik 1994. Prezantimi i letrave kredenciale: 17 tetor, 1994. Përfundimi i Misionit: më 15 mars, 1996.



William E. Ryerson

Shteti i Rezidencës: Virxhinia. Zyrtar i Shërbimit të Huaj. Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe i Plotfuqishëm i emëruar më 2 dhjetor 1991. Prezantimi i letrave kredenciale: 21 dhjetor 1991. Përfundimi i Misionit: më 13 tetor, 1994. Shtetet e Bashkuara rifilluan marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë më 15 mars 1991. Ambasada në Tiranë u hap më 1 Tetor 1991 me Kristofer Hill si i Ngarkuar me Punë.



Hugh G. Grant

Shteti i Rezidencës: Alabama. I emëruar jo karrierë. I Dërguar i Jashtëzakonshëm dhe Ministër i Plotfuqishëm. I emëruar më 9 gusht 1935. Përfundimi i Misionit: Forcat Italiane pushtuan Tiranën më 8 prill, 1939. Legata në Tiranë u mbyll zyrtarisht më 16 shtator 1939, Grant u largua më 27 shtator 1939.



Post Wheeler

Shteti i Rezidencës: Washington. Zyrtar i Shërbimit të Huaj. I Dërguar i Jashtëzakonshëm dhe Ministër i Plotfuqishëm, i emëruar më 26 gusht 1933.

Prezantimi i letrave kredenciale: më 28 nëntor 1933. Përfundimi i Misionit: U largua më 1 nëntor 1934.



Herman Bernstein

Shteti i rezidencës: Nju Jork. I emëruar jo karrierë. I Dërguar i Jashtëzakonshëm dhe Ministër i Plotfuqishëm, i emëruar më 17 shkurt 1930. Prezantimi i letrave kredenciale: më 28 prill 1930. Përfundimi i Misionit: U largua më 24 shtator 1933.



Charles C. Hart

Shteti i Rezidencës: Rrethi Kolumbia. I emëruar jo karrierë: I Dërguar i Jashtëzakonshëm dhe Ministër i Plotfuqishëm, i emëruar më 27 maj 1925. Prezantimi i letrave kredenciale: 1 gusht 1925.

Përfundimi i Misionit: Ri-akredituar kur Shqipëria u shpall një mbretëri.

Prezantimi i letrave kredenciale më 13 dhjetor 1928. La postin më 12 dhjetor 1929.



Ulysses Grant-Smith

Shteti i Rezidencës: Pensilvania. Zyrtar i Shërbimit të Huaj. I Dërguar i Jashtëzakonshëm dhe Ministër i Plotfuqishëm, i emëruar më 22 shtator 1922. Prezantimi i letrave kredenciale: 4 dhjetor 1922. Përfundimi i Misionit: U largua më 8 shkurt 1925.



Njoftim!

Mbi datat, procedurat dhe dokumentacionin e aplikimit, konkurrimit dhe regjistrimit për pranim në ciklin e parë të studimeve, programi Bachelor, në tre degët: 1. Shkenca Ushta-rake; 2. Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes; 3. Navigim dhe Komandim Detar në Fushën e Mbrojtjes, për vitin akademik 2022-2023.

Njoftojmë të gjithë të interesuarit se Akademia e Forcave të Armatosura (Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë) hap regjistrimet për pranim në ciklin e parë të studimeve, programi Bachelor, për vitin akademik 2022-2023.

Datat e aplikimit, konkurrimit të aplikantëve/kandidatëve dhe regjistrimit të fituesve (Raundi i Parë) do të jenë si më poshtë vijon:

- Regjistrimi i aplikantëve për konkurrim:
08 - 11 gusht 2022, (orari 09:00 - 16:00)

- Shpallja e listave të aplikantëve të regjistruar për konkurrim:
11 gusht 2022

- Zhvillimi i konkursit (testimeve):
15 - 20 Gusht 2022

- Ekzaminimi mjekësor
- Testimi fizik
- Testimi intelektual
- Testimi psikologjik

- Shpallja e kandidatëve fitues: 30 Gusht 2022.
- Ankimimi: 01 Shtator 2022.

- Regjistrimi i kandidatëve fitues të raundit të parë: 02 - 15 Shtator 2022.

- Çregjistrimi i aplikantëve fitues: 16 - 17 Shtator 2022.

- Dokumentacioni i aplikimit për konkurrim (Raundi i Parë):

- Dokument identifikimi (dokument origjinal dhe një fotokopje e kartës së identitetit/pasaportës);

- Kërkesë me shkrim e aplikantit, për ndjekjen e studimeve;

- Certifikatë familjare, copë 1 (një);

- Fotografi për dokument, në përmasat (4 x 6), copë 2 (dy);

- Fotokopje e noterizuar e diplomës së maturës shtetërore ose e dëftesës së pjekurisë, së bashku me certifikatën e notave, ose të një dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit dhe të njehsuar në QSHA;

- Raport mjekësor mbi aftësinë shëndetësore për studime, lëshuar nga mjeku i familjes i qendrës shëndetësore të vendbanimit të aplikantit, shoqëruar edhe me një raport shpjegues në të cilin të deklarohet se kandidati është i shëndetshëm, (nuk ka sëmundje kronike, infektive, të shëndetit mendor në anamnezën e tij personale, si dhe që nuk është përdorues i lëndëve narkotike);

- Fletë analiza mjekësore, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjaku dhe/ose bankat e gjaku apo drejtoritë e Shëndetit Publik në prefekturat apo rrethet ku banojnë, për agjentë infektivë (Hepatit

REKRUTIM
FORCAT E ARMATOSURA
TË SHQIPËRISË

3 ARSYE PSE DUHET TË ZGJEDHIM
AKADEMINË E FORCAVE TË
ARMATOSURA

PAGESË MUJORE NDIHMËSE PËR ÇDO STUDENT
PËR TË GJITHË PERIUdhËN E STUDIMIT

AKOMODIM DHE USHQIM FALAS
PËR 3 VITET E STUDIMIT NË AKADEMI

TARIFË STUDIMI
0 LEKË NË VIT

REGJISTROHU TANI PËRMES PORTALIT U-ALBANIA
www.mod.gov.al

B; Hepatit C; Hepatit D; HIV/AIDS, sifiliz); grupin e gjakut, si dhe testet për lëndë narkotike lëshuar nga laboratorë të certifikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

1. Deklaratë e aplikantit, (Shtojca 1);

2. Formular i të dhënave personale të aplikantit (Aneksi A), mbi të dhënat personale të aplikantit;

3. Formular vetëdeklarimi (Aneksi B), mbi të dhënat personale të aplikantit në lidhje me statusin juridik;

4. Formular vetëdeklarimi për gjendjen shëndetësore të kandidatit për oficer aktiv (Aneksi C);

5. Mandat pagesë e tarifës së konkurimit në vlerën 2 000 lekë për studentët që regjistrohen për diplomë të parë Bachelor dhe në vlerën 4 000 lekë për studentët që regjistrohen për diplomë të dytë Bachelor.

- Për sa më sipër sqarojmë se, formularët “Shtojca 1”; “Aneksi A”, “Aneksi B”, “Aneksi C”, si “Fatura për pagesë të tarifës së aplikimit”, do të ofrohen nga personeli i sekretarisë mësimore për plotësim/nënshkrim nga aplikanti, ditën e aplikimit.

- Dokumentacioni shtesë për regjistrimin e kandidatëve të shpallur fitues të konkursit:

1. Dëshmi penaliteti;
2. Vërtetim nga gjykata;
3. Vërtetim nga prokuroria;
4. Vërtetim nga përmbartimi.

Të dhënat për rregulloren e konkursit, testeve, gjenden në faqen zyrtare të AFA-së dhe të Ministrisë së Mbrojtjes.

Publikimi i listës së renditjes së aplikantëve fitues do të bëhet brenda datës 30 gusht 2022, duke përdorur si element identifikues vetëm ID e aplikantëve.